



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 20 (827875)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 17 maj 2024



Sot bazë e NATO-s, 69 vite histori suksesi



» faqe 6

Në vitin 1958, me Vendim të Këshillit të Ministrave, u formua Shkolla e Lartë Ushtarake në qytetin e Tiranës. Kjo shkollë funksionoi fillimisht me një program mësimor 3-vjeçar. Në vitin 1962, institucioni u emërtua Akademia Ushtarake dhe oficerët konsideroheshin me arsim të lartë ushtarak, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 28 tetor 1961. Kjo Akademi u krijua si një institucion shtetëror, në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me status të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Akademia është institucion i lartë mësimor-edukativ e shkencor që shërben për kualifikimin e kuadrove të lartë të FA-së. Vendimi përbënte një vlerësim për shkollën, por edhe një dukuri të re në fushën e arsimit dhe të kualifikimit të oficerëve. Ishte kjo një arritje e nxitje për rritjen e cilësisë e të veprimtarisë mësimore, pedagogjike dhe studimore e shkencore të këtij institucioni. Të gjitha këto u reflektuan në format organizative, në plan-programet mësimore, në rritjen e kërkesave profesionale ndaj metodave të mësimdhënies nga trupa pedagogjike, si dhe në zbatimin e kriterëve bashkëkohore të pranimit të akademistëve që ndiqnin studimet në akademi.

Në vitin 1973, Akademisë iu dha e drejta për dhënien e gradave shkencore për kuadrot ushtarakë. Në vitin 1975, Akademia Ushtarake u cilësua nga Këshilli i Ministrave, si institucioni i vetëm për kualifikimin e kuadrove të Ushtrisë, ndërsa në vitet 1990, iu dha e drejta e propozimeve për tituj shkencorë.

Nga viti 1984 e deri sot, në Akademinë e Mbrojtjes janë mbrojtur mbi 130 doktorata nga kuadro të fushave të ndryshme, shumica e të cilëve pedagogë e punonjës shkencorë të saj, midis tyre dhe “Profesor i Asociuar” e “Profesor”. Sot, në fushën e kualifikimit shkencor, Akademia e Forcave të Armatosura, sipas ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtën të organizojë studime të thelluara pasuniversitare në fushën e mbrojtjes e të sigurisë të nivelit “Master”, organizimin e doktoratës dhe klasifikimin e punonjësve shkencorë. Me rastin e 66-vjetorit të krijimit të këtij institucioni të rëndësishëm

Krijimi i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, 66 vite arsimim profesional të përgatitjes së leadershipit në fushën e sigurisë e mbrojtjes



të arsimit ushtarak, komandanti i KMS-së, gjeneral brigade Ylli Pulaj dërgon një mesazh urimi, për të gjithë kontributorët e saj, drejtues, staf akademik, kursantë:

“Të nderuar pedagogë, kursantë dhe personel i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë!

10 maji është një nga ditët më të rëndësishme në historinë e arsimit ushtarak shqiptar, është dita e krijimit të Akademisë së Mbrojtjes, sot Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, dhe sot mbushen 66 vjet nga krijimi i tij.

Dëshiroj me këtë rast, të përcjell urimet e mia

më të përzemërta për të gjithë kursantët, pedagogët dhe personelin jo akademik, ushtarak dhe civil që sot janë pjesë e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Një urim të veçantë do të përcillja për të gjithë komandantët e pedagogët që kanë shërbyer në këtë institucion ndër vite, të cilët e ngritën, forcuan e transformuan me synimin e përgatitjes së oficerëve komandues në nivel shtabi, të aftë për të vepruar në mjedise komplekse, për të vlerësuar dhe adresuar me efektivitet problemet komplekse dhe të paqarta që lidhen me sigurinë kombëtare dhe më gjerë.

Puna dhe kontributi juaj i vyer e i përditshëm,

gjithnjë e më shumë po i shërben rritjes dhe konsolidimit të Kolegjit dhe shndërrimit të tij nga një institucion me kontribut kombëtar, në një kontribuues dhe ofrues i programeve për homologët tanë në rajon e më gjerë. Shembull domethënës për këtë është Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, në të cilin marrin pjesë vetëm gjatë këtij viti, tetë vende nga shtetet anëtare të Aleancës dhe vendeve partnere.

Ambicia e Kolegjit në zbatim të direktivës së ministrit të Mbrojtjes dhe vizionit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, 2022-2025, është modernizimi i kurrikulave dhe krahas zhvillimit të mësimit në gjuhën angleze për KLSM, po kështu zhvillimi i moduleve në gjuhën angleze edhe për kurset e tjera me synimin përfundimtar zhvillimin e kurseve në anglisht.

Në këtë 66-vjetor të KMS-së, një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që pavarësisht se nuk janë drejtpërdrejt pjesë e Kolegjit, me mbështetjen e tyre kanë qenë, janë e do të jenë pjesë e rëndësishme e suksesit dhe arritjeve.

Ndërsa festojmë 66-vjetorin e Krijimit, jam i bindur se Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë ka potencialin dhe aftësitë të përshtatet e transformohet në mënyrë të vazhdueshme për t’iu përgjigjur sfidave të së ardhmes për të përmbushur misionin e tij fisnik të përgatitjes së leadershipit në fushën e sigurisë e mbrojtjes për personelin ushtarak dhe atë civil.

Gëzuar 66-vjetorin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë!”, - mbylli urimin për këtë datë të shënuar, gjeneral brigade Ylli Pulaj.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj merr pjesë në “Konferencën e 53-të të Komandantëve të Kolegjeve të Mbrojtjes së NATO-s”

Me ftesë të gjenerallejtënant Max A.L.T. Nielsen komandant i Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s, gjeneral brigade Ylli Pulaj mori pjesë në “Konferencën e 53-të të komandantëve të Kolegjeve të Mbrojtjes së NATO-s (CoC 2024)”. Konferenca vjetore u organizua nga Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s, në bashkëpunim me Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes dhe u mbajt për herë të parë në Washington D.C.

Konferenca u zhvillua në kuadër të 75-vjetorit të krijimit të NATO-s. Në këtë event të veçantë morën pjesë drejtues të lartë nga institucionet arsimore ushtarake dhe të mbrojtjes në mbarë botën për të diskutuar aftësitë e leadershipit dhe sfidat e paraqitura nga mjedisi i ardhshëm operativ. Tema e konferencës ishte “Zhvillimi i leadershipit për 75 vitet e ardhshme të Aleancës”, ku diskutimet u fokusuan në: Edukimin e leadershipit në NATO, politikat aktuale dhe të ardhshme të trajnimeve dhe programet për zhvillimin e leadershipit, sfidat dhe mundësitë e së ardhmes, tendencat që do të ndryshojnë mjedisin për NATO-n dhe liderët e së ardhmes si dhe përgatitja e udhëheqësve strategjikë për të vepruar strategjikisht gjatë 75 viteve të ardhshme.



KONFERENCA VJETORE U ORGANIZUA NGA KOLEGJI I MBROJTJES I NATO-S, NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN KOMBËTAR TË MBROJTJES DHE U MBAJT PËR HERË TË PARË NË WASHINGTON D.C.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj gjatë konferencës së 53-të të komandantëve të Kolegjeve të Mbrojtjes së NATO-s (CoC 2024), kishte kënaqësinë të takonte Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, z. Ervin Bushati. Në takimin e zhvilluar, ndër të tjera u bashkëbisedua mbi sfidat dhe kërcënimet që Aleanca e Atlantikut të Veriut po përballlet në ditët e sotme.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti SHSHP të Forcave të Armatosura norvegjeze, gjeneral Eirik Kristoffersen

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti në një takim zyrtar Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura norvegjeze, gjeneral Eirik Kristoffersen. Në këtë takim u shkëmbyen pikëpamjet në lidhje me sfidat dhe mundësitë e bashkëpunimit të ardhshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si hap i rëndësishëm drejt njohjes dhe forcimit të lidhjeve të sigurisë ndërkombëtare. Gjatë bashkëbisedimit u theksua rëndësia e bashkëpunimit global për sigurinë dhe mbrojtjen.



Ambasadori i Gjermanisë dhe i Spanjës, të ftuar nderi në KLSM-14

Në vijim të programit akademik, KLSM-14 ka pritur si lektor nderi Ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri z. Karl Bergner. Ambasadori i shtetit Gjerman, zoti Bergner prezantoi temën “Strategjia e Sigurisë Kombëtare”, duke u ndaluar tek vlerësimi i përgjithshëm mbi integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe situatën gjeostrategjike të saj.

Më pas, zoti Bergner i shoqëruar nga Atasheu Ushtarak, nënkolonel Hans Peter Wamsler, u prit në një takim kortezie nga gjeneral brigade Ylli Pulaj, me të cilin bashkëbiseduan mbi rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit në fushën e arsimit mes dy vendeve.

Në vijim pjesëmarrësit në Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen pritën si “Guest Speaker” Ambasadorin e Spanjës rezident në Shqipëri z. Alvaro Renedo Zalba, i cili bashkëbisedoi mbi temën “E ardhmja e Mbrojtjes Europiane”, duke u ndaluar tek impakti i luftës në Ukrainë dhe ndikimi i saj në vendet e rajonit dhe më gjerë.



KLSM-14, vizitë mësimore në Bruksel, Belgjikë

Në vijim të programit akademik, Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen zhvilloi vizita zyrtare në Komandën Strategjike të Aleancës për Operacionet SHAPE – HQ ACO (Supreme Headquarters Allied Powers Europe – Allied Command Operations) Mons si dhe në selinë e NATO-s.

Gjatë ditës së parë të vizitës, KLSM-14 u prit nga zëvendëshefi i Shtabit, gjeneralletjënant Hubert Cottureau, i cili i uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve të kursit dhe më pas i njohu ata mbi situatën aktuale të mjedisit të sigurisë dhe qasja ndaj fenomeneve të ndryshme. Më pas, me anë të prezantimeve nga përfaqësues të lartë të drejtorive të SHAPE, pjesëmarrësit u njohën me detyrat aktuale të NATO-s, kontributin e saj në KFOR, programet e trajnimeve në të ardhmen dhe zhvillimet e fundit në SHAPE (ACO dhe ACT) si dhe politikat e përbashkëta mbi stërvitjet.

Në vijim të ditës së dytë, KLSM – 14 vizitoi Shtabin e NATO-s në Bruksel, ku u prit nga ambasadori i Shqipërisë në NATO, z. Ilir Gjoni dhe nga përfaqësuesi ushtarak, gjeneral brigade Ilir Pujo, të cilët i uruan mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe i njohën me rolin dhe kontributin e Shqipërisë në operacionet e NATO-s dhe me gjerë.

Më pas përfaqësues të Divizionit të Politikave Publike Diplomatieke dhe Politikave të Sigurisë, prezantuan mbi punën e tyre ku të pranishmit u njohën mbi situatën aktuale të axhendës politike botërore, angazhimet në Ballkanin Perëndimor si dhe zhvillimet në inovacion dhe teknologjitë në NATO.

Më pas pjesëmarrësit në kurs dhe stafi akademik vizituan Memorialin Vaterlo, kompleksin muze belg të vendosur në fushën e betejës Vaterlo, ku u njohën me historinë e betejës përmes dioramave, uniformave, objekteve historike, hartave të animuara si dhe animacione multimediale.



Me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Norvegjisë, gjeneral Eirik Kristoffersen, zhvilloi në vendin tonë një vizitë zyrtare.

Gjeneral Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen gjeneral Kristoffersen dhe ekipit që e shoqëronte, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e kontributin që Norvegjia ka dhënë në proceset integruese të vendit tonë, për ndihmën e dhënë për Spitalin tonë Ushtarak, Shërbimin Hidrografik dhe Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturrës Ushtarake, dhe angazhimin në bashkëpunim me kompaninë EOD, në ndihmë të komunitetit për eliminimin e municioneve të paplasura në rajone të ndryshme të vendit tonë.

Takimi ndërmjet gjeneralmajor Kingjit dhe gjeneral Kristoffersen u fokusua në marrëdhëniet dypalëshe të bashkëpunimit ushtarak dhe nevojën për t'i zhvilluar ato në të ardhmen. Gjeneral Kingji ofroi një panoramë të zhvillimeve të fundit në Forcat e Armatosura të RSH, duke u ndalur në projektet e modernizimit, përmirësimin e kuadrit ligjor, rishikimin e dokumenteve strategjike, dhe kontributin në misionet e operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB.

Më tej, bashkëbisedimi u fokusua në zhvillimet e fundit në mjedisin e sigurisë në zonën Euro – Atlantike dhe sidomos në Ballkanin Perëndimor, ku influenca malinje dhe retorika konflikt-ndjellëse e disa aktorëve synon tensionimin e situatës dhe pengimin e zhvillimit normal të proceseve integruese.

Në këtë pikë, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e KFOR-it për sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës dhe rajonit, si dhe përgëzoi përpjekjet e Bashkimit Evropian dhe komunitetit ndërkombëtar për të zgjidhur

SHSHPFPA, gjeneralmajor Kingji: Mirënjohje për kontributin që Norvegjia ka dhënë në proceset integruese të Shqipërisë



problemet përmes dialogut, duke theksuar nevojën që palët të përmbahen nga përdorimi i forcës dhe narrativës armiqësore.

Po kështu, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e iniciativave rajonale për promovimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit në rajon, dhe synimin e tij për të përfutur nga udhëheqja nga vendi ynë gjatë këtij viti të iniciativave rajonale të Shefave të Shtabit të Ballkanit dhe Kartës së Adriatikut (U.S. Adriatic Charter), për të nxitur më tej stabilitetin rajonal, paqen dhe prosperitetin.

Gjeneral Kristoffersen falënderoi gjeneralmajor Kingjin për ftesën, vlerësoi rolin tonë për bashkëpunimin dhe stabilitetin në rajon, angazhimin në operacionet dhe misionet e drejtuara nga Aleanca dhe shprehu gatishmërinë për të nxitur më tej bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes ndërmjet forcave tona të armatosura.

Certifikohen kursantët e Kursit të Avancuar të Oficerit

Qendra Stërvitore në Komandën Mbështetëse zhvilloi ceremoninë për certifikimin e 16 kursantëve, të cilët përmbyllën me sukses Kursin e Avancuar të Oficerit në specialitetet furnizim dhe transport – mirëmbajtje.

Në këtë ceremoni morën pjesë, shefi i shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Idriz Kuca, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla dhe komandantë të strukturave vartëse.

Në fjalën e tij përshëndetëse, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, falënderoi kursantët për përkushtimin, duke theksuar se kurse të tilla janë të rëndësishme për thellimin e njohurive, rritjen profesionale dhe zhvillimin e mëtejshëm të karrierës ushtarake.

Oficerët e Kursit të Avancuar të Oficerit përvehtësuan njohuri teorike dhe praktike për drejtimin e kompanisë së furnizimit dhe transport-mirëmbajtjes si dhe zgjidhjen e detyrave taktike në operacione luftarake dhe jo luftarake.

Qendra Stërvitore në Komandën Mbështetëse vazhdon të përmbushë misionin e saj si një institucion i rëndësishëm arsimor.



U zhvillua Konferenca Përfundimtare Planëzuese "Antindotja 2024"

Në mjediset e Komandës së Distriktit Detar Verior u zhvillua Konferenca Përfundimtare Planëzuese për Stërvitjen "Antindotja-2024" me temë "Rritja e aftësive koordinuese dhe kompaktësimi i veprimeve të efektivave të anijeve në rast të ndotjeve detare, në bashkëpunim me institucionet e tjera me interesa në det në përgjigje të një emergjence civile ndaj një ndotje detare".

Në konferencë mori pjesë shefi i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes të Forcës Detare, kapiten i rangut dytë Emrush Bejdo, nga Distrikti Detar Verior morën pjesë personeli i Komandës, Flotiljes Detare, Kepi Palit, specialist nga Shtabi i Distriktit Detar Jugor dhe komandantë të anijeve pjesëmarrëse në stërvitje. Nga institucionet e tjera me interesa në det, në përgjigje të një emergjence ndaj një ndotje detare, morën pjesë përfaqësues nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Autoriteti Portual, Durrës, Kapitaneria e Portit Detar, Durrës, Policia Kufitare dhe Migracionit, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Agjencia Rajonale



e Bregdetit dhe Agjencinë e Zonave të Mbrojtura. Komandanti i Distriktit Detar Verior, kapiten i rangut të dytë Dritan Seraj, në fjalën e rastit

për çeljen e konferencës, iu uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, duke i falënderuar për pjesëmarrjen në konferencat e zhvilluara në interes të

stërvitjes si dhe angazhimin e institucioneve që ata përfaqësonin.

Gjatë konferencës u diskutuan: mënyra e zhvillimit të stërvitjes, modalitetet kryesore të Stërvitjes "Antindotja-2024", baza ligjore, koha e zhvillimit të stërvitjes dhe DVD - day, skenarin përfundimtar të stërvitjes, variantet e stërvitjes, skemat grafike, veprimet operacionale, koordinimin, komunikimin, etj.

Pjesëmarrësit në konferencë ndoqën me interes prezantimin dhe dhanë mendime, propozime dhe sugjerime në interes të zhvillimit të stërvitjes si dhe kryen deklarinimin përfundimtar të forcave dhe mjeteve pjesëmarrëse.

Stërvitja "Antindotja-2024" do të zhvillohet, më datë 19 qershor 2024, në Gjirin e Durrësit ndërsa Dita e Vizitorëve të Shquar do të zhvillohet, më datë 20 qershor 2024.

Në përfundim komandanti i Distriktit Detar Verior përmendi se siguria lundimore dhe zbatimi i ligjshmërisë në det është detyrë kryesore e Forcës Detar/Rojës Bregdetare.



Komandanti i Forcës Detare merr pjesë në CHENS24

Gjatë zhvillimit të CHENS24, samiti i Bashkimit Europian të Forumit të Shefave të Forcave Detare Europiane, në Brdo, Slloveni, morën pjesë krerët e forcave detare nga 24 shtete europiane, qofshin ato anëtare të NATO-s, të Bashkimit Evropian si dhe nga Shtabet e NATO-s.

Tema e këtij viti në CHENS ishte mbi "Kërcënimet dhe sfidat kibernetike detare".

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, gjatë pjesëmarrjes në CHENS24, pati dhe takime bilaterale me komandantët e Forcave Detare anëtare të NATO-s, gjatë së cilës diskutoi mbi planet e modernizimit dhe zhvillimit të Forcave Detare si dhe angazhimin e tyre në mbështetje të Aleancës.



Anija "Lissus" realizoi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane "Gromitz"

Anija "Lissus" dhe ekuipazhi i saj, pjesë e misionit të NATO-s, "Sea Guardian", në detin Egje, realizoi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane "Gromitz" në ujërat ndërkom-bëtarë, duke demonstruar aftësi të larta operacionale në operacionet detare.

Gjatë stërvitjes u realizuan skenarë stërvitorë sipas standardeve të NATO-s, për rritjen e aftësive dhe përgatitjes së ekuipazheve për situata dhe sfida të ndryshme në det.

Bashkëpunimi dhe koordinimi mes dy forcave dëshmoi një nivel të lartë të përgatitjes dhe angazhimit të ekipit, gjithashtu njëkohësisht u dhanë vlerësimet më të larta për profesionalizmin e efektivëve tanë.



Niset Kontingjenti i Parë shtesë me mision në Pejë, Kosovë

Në ambientet e garnizonit të Vaut-Dejës, Shkodër, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave të Kontingjentit të Parë shtesë të Forcës Tokësore nga efektivit i Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut, që do të dërgohet me mision në operacionin ushtarak të NATO-s, në përbërjen e kompanisë bullgare të manovrës si pjesë e Batalionit Kinetik, në komandën rajonale Pejë, Kosovë, KFOR. Në këtë ceremoni përcjelljeje ishin të pranishëm dhe familjarë të efektivit që shkon me mision.

Të pranishmit i përshëndeti komandanti i Regjimentit të Këmbësorisë të Veriut, (RKV) nënkolonel Ali Mali, i cili, pasi përshëndeti familjarët, u shpreh se: "Regjimenti i Këmbësorisë Veriut ka krijuar një traditë me vlera të mëdha në kryerjen me sukses të misioneve në përbërje të NATO-s. Kam besimin se dhe ky mision i radhës do të jetë në nivelin e kërkuar në përfaqësimin e vendit tonë në mbrojtje të paqes e sigurisë në rajon".

Kontingjenti shtesë, përbëhet nga një togë e efektivëve të RKV-së dhe do t'i bashkohet trupave të kontingjentit të Forcës Tokësore që ndodhen aktualisht në Pejë, Kosovë, në përbërje të kompanisë bullgare të manovrës, pjesë e Batalionit Kinetik, në Komandën Rajonale Perëndimore (PC-W) Pejë, Kosovë, KFOR. Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.



Komandanti i Forcës Tokësore priti shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Norvegjisë, gjeneral Eirik Kristoffersen

Në Regjimentin e Forcave Speciale, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në takim shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura norvegjeze, gjeneral Eirik Kristoffersen.

Gjeneralmajor Xhebexhia, pasi i uroi mirëseardhjen gjeneral Kristoffersen vlerësoi mbështetjen e FA-ve të Norvegjisë në drejtim të modernizimit të ushtrisë shqiptare si dhe bashkëpunimin e ngushtë të dy ushtrive tona në kuadër të NATO-s. Gjeneral Kristoffersen shprehu falënderimin e tij për kontributin që Forcat e Armatosura, dhe në veçanti FT, ka dhënë në stabilitetin në Ballkan me prezencën në KFOR, Kosovë si dhe prezencat në misionet e mëparshme të Afganistanit dhe Irakut.

Më tej, takimi vijoi me diskutimin për situatën e sigurisë në rajon e më gjerë si dhe detyrat që dalin para dy ushtrive anëtare të Aleancës Atlantike në përbashkimin e situatave të ndryshme dhe rritjen e sigurisë. Aty u shpreh nevoja që dhe Forcat e Armatosura tashmë duhet të ndryshojnë qasjen në realizimin e stërvitjeve, duke i kryer ato në skenarë sa më realë me kushtet e luftës.

Në këtë aspekt, gjeneral Eirik Kristoffersen shprehu dëshirën për një bashkëpunim të shtuar në stërvitje të përbashkëta të dy forcave të armatosura, ofrimin e kurseve dhe trajnimit për përdorimin e armëve, rritjen e nivelit të bashkëpunimit në lidhje me trajnimin e GBKL, Forcat Speciale dhe ato Komando. Më tej ai dhe ekipi që e shoqëronte u informuan për misionin, detyrat dhe planet e modernizimit të Forcës Tokësore.



Regjimenti i Aviacionit Luftarak, Kuçovë

Baza e Kuçovës është reparti i parë i Aviacionit me avionë reaktivë. Data 15 maj e vitit 1955 është dita e krijimit të regjimentit, ligjëruar pas vendimit të Kuvendit Popullor nr. 81, datë 06.11.1956. Regjimenti përbëhej nga dy skuadrilje avionësh reaktive MIG-15, të cilët, pasi u montuan në aerodromin e Tiranës dhe u kolauduan nga dy pilotët rusë, u dislokuan në aerodromin e Kuçovës, të porsa ndërtuar nga xhenierët shqiptarë.

Më 15 maj, regjimentit iu dorëzua Flamuri Luftarak “Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës PEZA”. Ky lajm i botuar në gazetën zyrtare të vitit 1956 është padyshim një nga ngjarjet me rëndësi për kohën dhe vendin e varfër të Ballkanit.

Komandant u caktua Niko Hoxha, zëvendëskomandant Fahri Bubësi, zëvendëskomandant për punën politike, Babaçe Faiku, kryeinxhinier Qirjako Trebicka, komandant i skuadriljes së parë Vasil Trasha, inxhinier skuadrilje Daut Gurabardhi, komandant i skuadriljes së dytë Peço Polena, inxhinier skuadrilje Hajrulla Jubani, navigator i repartit Masar Aga, ndërsa për nënrepartet e shërbimit Simon Nasko, Shef ndërlidhje Sotir Kano, komandant i shërbimit të radio-dritës Andrea Kule,

Efektivi pilot e teknik i këtij regjimenti, në pjesën më të madhe ishte përgatitur fillimisht në ish-Jugosllavi e më pas në ish-Bashkimin Sovjetik. Prej kohësh, në Kuçovë ishin sistemuar e kishin filluar përgatitjet pilotë të shquar, si: Niko Hoxha, Edip Ohri, Babaçe Faiku, Fahri Bubësi, Vasil Trasha, Masar Aga, Elmaz Hasanmataj, Refat Kasimati, Peço Polena, Sazan Xhelo, Koço Andoni, Lulo Musaj, Goxho Kondi, Kosta Dede, Tomorr Avdia, Zebo Dyrmishi, Seo Trola, Bajram Hita, Hektor Lako etj.

Po kështu edhe mjaft teknikë të përgatitur, si: Qirjako Trebicka, Met Farka-inxhinier i armatimit, Sokrat Manastirliu-inxhinier për pajimet speciale, Raqi Sevo, Shaqo Hoxha-inxhinier për radion, Daut Gurabardhi, Servet Tusha, Yzedin Koçi, Foto Lako, Hajrulla Jubani, Novruz Kacileri, Qani Veizi, Nexhip Nanushi, Jorgji Bitri, Hamdi Mullaj, Petrika Manastirliu, Kristo Pulla, Nevruz Selami, Stavri Gerdupi, Teki Goxhaj etj. Në janar të vitit 1956, në regjiment filloi viti i rregullt i përgatitjes luftarake. Në këtë vit një pjesë e pilotëve u nisën për studime për helikopterë në ish-Bashkimin Sovjetik.

Në korrik të vitit 1957, për herë të parë u ul avioni bombardues f128, i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Vetëm dy vjet pas krijimit të regjimentit, në Kuçovë filloi përgatitja e pilotëve për Klasin e Parë. Në nëntor të atij viti u titulluan pilotë të Klasit të Parë: Niko Hoxha, Edip Ohri, Fahri Bubësi, Babaçe Faiku, Vasil Trasha, Haki Jupasi, Thanas Gjikhuri. E gjithë kjo përgatitje e lartë e pilotëve duket se pati rast “të testohet” në dhjetorin e po atij viti, pasi çifti i avionëve roje, pas dhënies së sinjalit për shkellen e



Sot bazë e NATO-s, 69 vite nga krijimi i Regjimentit të Parë të Aviacionit Ushtarak Shqiptar në Kuçovë

hapësirës ajrore, u ngrit në ajër dhe detyroi të ulet në aerodrom një avion transporti anglez “Skaimaster”.

Presidiumi i Kuvendit Popullor, me vendim nr. 2651 dt.

26.04.1958, për kryerjen me sukses të kësaj detyre, i dekoroi pilotët Kosta Dede e Mahmut Hysa, si dhe avion-drejtesin Shyqyri Balla.

Në muajin prill të vitit 1959, filloi puna për remontin e mesëm të avionit MIG-15 me efektivat e repartit. Ish-Bashkimi Sovjetik ishte tepër larg për të kërkuar që një gjë e tillë të realizohej në vendin që prodhonte avionët. U krijua një grup remonti pranë oficinës së mirëmbajtjes së avionëve, i përbërë nga inxhinierët Stefan Kagjini, Nexhip Manushin dhe Nasi Themelin, ndërsa nga inxhinierët e naftës u caktuan Petrika Ballauri, Koço Pepa dhe Llazar Kreshpani.

Në vitin 1960 u hodh ideja e prodhimit të vajgurit në vendin tonë, dhe për këtë u kërku një bashkëpunim i ngushtë me inxhinierët e naftës. Nga reparti i Kuçovës me këtë detyrë u ngarkua një grup pune me në krye inxhinierin Stefan Kagjini dhe me Nexhip Manushin e Nasi Themelin, ndërsa nga inxhinierët e naftës u caktuan Petrika Ballauri, Koço Pepa e Llazar Kreshpani. Në muajin prill të vitit 1961, u bë për herë të parë eksperimentimi i karburantit të markës shqiptare, prodhuar nga punonjësit e laboratorit të naftës, ndërsa komandanti Niko Hoxha bëri me sukses provën në ajër me avionin 332.

Më 12 prill të vitit 1968, piloti Qirjako Dhima kreu me sukses kontrollin teknik të avionit MIG-15, pas kryerjes për herë të parë të riparimit kapital nga Uzina e Aviacionit. Më 13 maj 1983, u bë kontrolli në ajër i motorit të avionit MIG-19, pas riparimit kapital të tij në uzinë nga piloti Harilla Rebi, eksperiment ku mori pjesë zëvendëskryeministri Simon Stefani.

Dy vjet më vonë, në maj të viti 1985, pilotët Epaminonda Tupa dhe Koço Biku kryen provën e motorit të parë të avionit MIG-15, pas riparimit të këtij të fundit në vend.

Në vitin 1980, nga efektivi inxhiniero-teknik i këtij reparti ishte





prodhuar banko-prova për kontrollin e topave 30mm, si dhe pajisja për kontrollin e frenimit automatik të rrotave.

Në vitin 1974 ky regjiment mori pjesë në paradën ushtarake me 27 avionë në fluturim, tri treshe avionësh MIG-19, tri treshe avionësh MIG-17 dhe tri treshe avionësh MIG-15. I veçantë është edhe roli kinematografik i këtij reparti.

Në mars të vitit 1981 ai dha një ndihmë të çmuar në realizimin e filmit artistik me titull ‘Gjurmë në kaltërsi’ të Kinostudios ‘Shqipëria e Re’, kushtuar armës së aviacionit. Pilotët Harilla Rebi, Viktor Vangjeli, Agim Balili, Gjergji Spaho etj., ishin protagonistë të filmit, por edhe kryen një sasi të madhe fluturimesh në funksion të filmit.

23 dhjetor, një avion luftarak amerikan i tipit T-33 shkeli hapësirën ajrore shqiptare. Dy avionë të tipit MiG-15 u ngritën nga baza ajrore e Kuçovës, të pilotuar nga Anastas Ngjela dhe Mahmut Hysa. Avioni ulet në pistën e pambaruar të Rinasit. Avioni u sekuestrua, ndërsa piloti amerikan u lirua më 11 janar

1958, pas disa vitesh të qëndrimit të tij në rrethinat e repartit të Rinasit, maketi i këtij avioni u vendos në muzeun e armëve në kështjellën e Gjirokastrës.

Më 31 dhjetor 1958, një avion tjetër i huaj u kap nga avionët reaktivë të bazës së Kuçovës. Ky ishte një C-54D “Skymaster”. Avioni u detyrua të ulej në bazën e Kuçovës, dhe më pas pilotët dhe avioni u liruan.

Shtator 1959, regjimenti merr pjesë në stërvitjen me trupat e armatës në rajonin e Ersekës. Në këtë stërvitje u bë imitimi i hedhjes së bombës atomike nga zëvendëskomandanti i regjimentit Fahri Bubësi. Po gjatë këtij viti, u krye përvetësimi i uljes dhe ngritjes në dy aerodrome fushore, në atë të Shkodrës dhe të Pish-Poros. I pari u ul piloti Niko Hoxha dhe pas tij Fahri Bubësi, Koço Andoni, Tomor Avdia, Goxho Kondi, Sali Dibra, Sokrat Prifti.

Qershor 1961, repartit ribazohet në aerodromin e Pish-Poros, ku filluan fluturimet intensive ditën dhe natën. Ky ishte ribazimi i parë për të gjithë regjimentin në një aerodrom fushor.

Mars 1965, u krijua skuadrilja e tretë reaktive-mësimore, për përgatitjen e pilotëve e teknikëve të rinj, me komandant Sali Dibrën.

Prill 1966, repartit u pajis me një skuadrilje MIG-17.

Korrik 1967, u bë eksperimentimi i uljes dhe ngjitjes në aerodromin e Cërrikut me dy avionë MIG-15, me pilotët Viktor Vangjeli e Qirjako Dhima dhe një avion MIG-17 me pilot Azbi Seranin.

U eksperimentua ulja e dy çifteve me avionë MIG-17 në aerodromin e Korçës, nga pilotët Azbi Serani, Qirjako Dhima, Hamza Koçi e Harilla Rebi.

Qershor 1970, në Kuçovë fillojnë fluturimet avionët MIG-19. Më 3 nëntor për herë të parë filloi të kryhet shërbimi me avionët MIG-19.

Shtator 1976, zhvillohen qitje me raketa e topa natën. Në tetor, largohet nga repartit skuadrilja e avionëve MIG-19 me komandant skuadrilje Et’hem Alija dhe Hamza Koçi, që i kalojnë Regjimentit të ri Gjadër.

Dhjetor 1983, u eksperimentua ngritja nga pista urgjente nga pilotet Harilla Rebi e Gjergj Spaho.

Komandantë të Regjimentit të Kuçovës

Kolonel Niko Hoxha, Fahri Bubësi, Refat Kasimati, Bardhyl Taçi, Harilla Rebi, Vasil Andoni, kolonel Agim Balili, kolonel Fatmir Meçe, kolonel Agim Matraku, kolonel Gëzim Ismaili, kolonel Epaminonda Tupa, nënkolonel Andon Todri, nënkolonel Flamur Hoxha, nënkolonel Tomorr Dyrma, kolonel Syrja Gjoka.

Kolonel Niko Hoxha u caktua komandant i regjimentit të aviacionit në Kuçovë, më 15 maj 1955. Komandant Niko Hoxha ra në krye të detyrës, më 21 nëntor 1965, ndërkohë që kryente detyrën e komandantit të Regjimentit të Rinasit.

Sot, pas 69 vitesh Regjimenti i Kuçovës është në një dimension të ri ‘Baza Ajrore Taktike e NATO-s, me infrastrukturë moderne për flotën shqiptare të helikopterëve e dronëve të armatosur dhe avionët luftarakë të Aleancës, e cila do të shërbejë edhe për të çuar në një tjetër nivel përgatitjen e aviatorëve shqiptarë, ndërkohë që i jep Shqipërisë një rëndësi të re gjeostrategjike.

Si baza më e madhe e NATO-s në rajon, kjo infrastrukturë e rëndësishme, jo vetëm që rrit profilin e Shqipërisë në skenën ndërkombëtare, por gjithashtu forcon angazhimin e vendit për paqe dhe siguri në rajon, duke u kthyer në një aset të vyer të Aleancës.

Riaktivizimi i këtij aeroporti ushtarak është njëkohësisht edhe pjesë e ripërtëritjes dhe rritjes së mëtejshme cilësore të flotës sonë ajrore. Dy helikopterët e rinj “Black Hawk” si dhe dronët “Bayraktar” janë pjesë e një rritjeje që do të vazhdojë.

SI BAZA MË E MADHE E NATO-S NË RAJON, KJO INFRASTRUKTURË E RËNDËSISHME, JO VETËM QË RRIT PROFILIN E SHQIPËRISË NË SKENËN NDËRKOMBËTARE, POR GJITHASHTU FORCON ANGAZHIMIN E VENDIT PËR PAQE DHE SIGURI NË RAJON, DUKE U KTHYER NË NJË ASET TË VYER TË ALEANCËS.

NË VITIN 1974 KY REGJIMENT MORI PJESE NË PARADËN USHTARAKE ME 27 AVIONË NË FLUTURIM, TRI TRESHE AVIONËSH MIG-19, TRI TRESHE AVIONËSH MIG-17 DHE TRI TRESHE AVIONËSH MIG-15. I VEÇANTË ËSHTË EDHE ROLI KINEMATOGRAFIK I KËTIJ REPARTI.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Duke u dhënë shumë pas lukseve dhe dynjasë, po harrojmë vuajtjet e jetimit dhe fukarasë. Duke u dhënë shumë pas shoqërisë, po harrojmë detyrimet e shtëpisë. Duke u dhënë shumë pas rrjeteve sociale, po lemë anash jetën reale. Duke u dhënë shumë pas qejfeve të vetes, po i harrojmë më të dashurit e jetës. Duke u dhënë shumë pas pasurisë, po harrojmë vlerën e familjes dhe shoqërisë.

Çdo epokë e kohë ka banalitetet e veta, por kjo kohë moderne ka shumë të tilla; ka ‘idiotin e ri’, që duke synuar një mënyrë jetese pa probleme ekonomike e materiale, jetë luksi, jetesë të gatshme dhe emocionale në të njëjtën kohë kërcënon veten, shoqërinë dhe ambientin.

Prej çfarë po kërcënohet individi, shoqëria, kombi dhe ambient?

Po kërcënohen nga shija dhe motivimi materialist, se mund të kesh gjithçka dhe nga ai motivimi jo moral se mund të bësh ç’të duash, nga pasurimi i shpejtë dhe realizimi i dëshirave të shfrenuara me shpenzime të kota e të tepruara; diplomimi me dije të pamësuar, të kërcënuar prej alkoolit e drogës e të mashtruar prej reklamave, modës, luksit, pornofilit dhe telenovelave të fabrikuara. Po kërcënohen prej basteve, bixhozit e prostitucionit, rritjes së divorcit e të fëmijëve pa prindër, prej deficitit prindëror dhe atij të përgjegjësisë shoqërore. Bota moderne po sundohet prej vlerës së letrës së parasë, e cila bën pasurinë, blen e ç’ nderon pushtetin e politikën e cila korrupton shtetin dhe shoqërinë, zhvlerëson mendjen, talentin e moralin. Paraja dhe privatizimi i gjithçkaje nxisin individualizmin egoist, papërgjegjshmërinë dhe pandjesinë sociale.

Cili na qenka ky njeriu modern dhe ky ‘idioti i ri’?

Është politikan, biznesmen, profesor, doktor, filozof, punëtor krahu, i pasur, i varfër, jurist, administrator, etj.

‘Idioti modern’ i ardhur nga errësira ‘Dostojane’ apo ç’do kush kokëbosh, i mashtruar e i çmendur pas kënaqësive materiale të jetës dhe që bie pre e të këqijave të saj, dhe duke u mbërthyer nga lakmia e shfrenuar për lumturi, mendjemadhësi, kënaqësi e pasuri, gjë kjo që dëmton të mirat morale njerëzore dhe shkatërron burimet dhe begatitë që na ka mundësuar bujaria e planetit.

Edhe pse baza e shoqërisë moderne është mendimi racional, në kohën e sotme duket se shoqëria po merr gjithnjë e më shumë një pamje “irracionale”. Dinamizmi i brendshëm i mënyrës moderne të organizimit shoqëror i ka përshpejtuar ritmin dhe gjerësinë e ndryshimeve sociale në një shkallë të tillë që, për shkak të natyrës reflektive të zhvillimit shoqëror, bëhet gjithnjë e më e vështirë të parashikohen pasojat e zhvillimeve të ardhshme.


Disa prej tyre, madje, si rreziku i një lufte bërthamore, problemet e mëdha të ndotjes së mjedisit, ose ngrohja globale, me të cilat përballet i gjithë njerëzimi, mund të jenë tashmë përtej kontrollit tonë. Shoqëria e sotme moderne është globalizuar dhe po bëhet gjithnjë e më shumë globalizues. Ne përsëri besojmë se, së bashku, si pjesëtarë të së njëjtës race humane, duhet të përpiqemi t’u bëjmë ballë forcave sociale shkatërruese përmes modeleve pozitive, të mbështetura në realitet dhe të orientuara drejt së ardhmes.

Qeniet njerëzore janë pjesë integrale e natyrës, specia e llojit më të lartë që njohim deri më sot, e krijuar si rezultat i ndryshimeve evolucionale e selektive natyrore, të pa dizajnuara nga asnjë fuqi mbinatyrore.

Ne besojmë se jeta jonë tokësore është e vetmja jetë që kemi dhe, prandaj, ajo duhet jetuar e gëzuar sot, këtu në tokë, deri në fund dhe plotësisht. Kujtdo që shpreson dhe synon të arrijë lumturinë, le të ketë në konsideratë se: “Koha për të qenë të lumtur është sot. Vendi për të qenë të lumtur është këtu. Mënyra për të qenë të lumtur është që t’i bëjmë të tjerët të ndihen të tillë”.

Ne nuk u shmangemi të panjohurave dhe sfidave që mund të ndeshim në jetë, por përpiqemi t’u japim atyre kuptim, mbështetur në arsyen dhe me dëshirën e vullnetin për të çuar përpara njohjen tonë për botën që na rrethon e për ta vënë këtë njohje në dobi të shoqërisë.

Paradoksi i modernitetit dhe Erozioni i vlerave tradicionale



. Bota moderne po sundohet prej vlerës së letrës së parasë, e cila bën pasurinë, blen e ç’ nderon pushtetin e politikën e cila korrupton shtetin dhe shoqërinë, zhvlerëson mendjen, talentin e moralin. Paraja dhe privatizimi i gjithçkaje nxisin individualizmin egoist, papërgjegjshmërinë dhe pandjesinë sociale.

Liria dhe dinjiteti janë vlera njerëzore supreme

Vlerat etike të çdo individi dhe ato të shoqërisë burojnë nga nevojat dhe interesat njerëzore. Parimet dhe vlerat morale nuk duhet të jenë koncepte apo apriori. Për ne dobia apo drejtësia e tyre provohen në eksperiencën njerëzore. Duhet të besojmë se çdo njeri meriton një jetë dinjitoze dhe çdo liri që e mundëson atë të bëjë zgjedhje të informuara e të përgjegjshme.

Moderniteti ka ndikuar negativisht shoqëritë në shumë mënyra, sidomos shoqëritë e shteteve perëndimore. Erozioni i vlerave tradicionale dhe rënia e moralitetit në “jetët komunitare” është një çështje shqetësuese kudo. Më së shumti, fëmijët e shekullit XXI rriten dhe edukohen në mënyrë të tillë që të qëndrojnë në këmbët e tyre të palëkundur që herët në jetë. Këta bëhen të rinj të pavarur politikisht dhe ekonomikisht, shumë më herët se sa brezat e mëparshëm, por e gjitha kjo ka edhe koston e saj. Pavarësisht ekspozimit kaq të madh ndaj njohurive dhe zhvillimeve teknologjike, kompleksiteti në shoqërinë moderne vazhdon të rritet. Konkurrenca për të qenë në avantazh ndaj tjetrit “vret” vlerat njerëzore të përkujdesjes, ndarjes me të tjerët, dhe pranimin e tyre me zemër. Duket sikur gjithçka është transformuar në një “luftë pa rregulla” për fitime materiale. Duket sikur të rinjtë i kanë harruar disa rregulla sociale që duhen zbatuar. Rrallë shoh të rinj që thonë “Faleminderit” për shërbimet që marrin, qoftë edhe nëse ky falënderim shkon për kamerierin që u shërben atyre kafen e mëngjesit. Më së shumti ankohen se duan gjithmonë “më mirë” se kaq, duke harruar se ndryshimi nis nga vetja.

Me përshkrimin e modernitetit të shekullit XXI dhe stilin e jetës së kohëve modern nga George Carlin, komedian, kritik social, aktor dhe shkrimtar, do doja të bëhej zëri i së vërtetës së hidhur në këtë paradoks që jetojmë çdo ditë, të kthehet në atë që

me apo pa dëshirë po e ‘vrasim’, dinjitetin njerëzor, parimi i jetës së humanëve.

Paradoksi i kohës sonë është se ne kemi ndërtesa më të larta, por durim më të shkurtër, rrugë më të gjera, por pikëpamje më të ngushta. Shpenzojmë më shumë, por kemi më pak, blejmë më shumë, por e shijojmë më pak. Kemi shtëpi më të mëdha, por familje më të vogla. Kemi më shumë diploma, por më pak kuptim, më shumë njohuri, por më pak gjykim, më shumë ekspertë, akoma më shumë probleme, më shumë ilaçe, por më pak mirëqenie. Ne pimë shumë, tymosim shumë, shpenzojmë në mënyrë të pakujdesshme, qeshim pak, ecim shpejt, inatosemi shpejt, qëndrojmë zgjuar deri vonë, zgjohemi shumë të lodhur, lexojmë pak, shohim TV shumë dhe lutemi rrallë. Kemi shumëfishuar pasurinë, por kemi reduktuar vlerat. Ne flasim shumë, duam rrallë dhe urrejmë shpesh. Kemi mësuar si të bëjmë një jetesë, por jo një jetë. I shtojmë vite jetës, jo jetë viteve. Kemi bërë gjithë rrugën për në hënë e jemi kthyer, por e kemi të vështirë të kalojmë rrugën për të takuar një komshi të ri. Kemi pushtuar hapësirën e jashtme, por jo hapësirën e brendshme. Kemi bërë gjëra më të mëdha, por jo më të mira. Kemi pastruar ajrin, por kemi ndotur shpirtin. Kemi ndarë atomin, por jo paragjykimet tona. Shkrualjmë më shumë, por mësojmë më pak. Planifikojmë më shumë, por realizojmë më pak. Kemi mësuar të nxitojmë, por jo të presim. Ndërtojmë më shumë kompjuterë që të mbajnë më shumë informacion, të prodhojnë më shumë kopje se kurrë më parë, por komunikojmë gjithmonë e më pak. Është koha e ushqimeve të shpejta dhe tretjeve të ngadalta, njerëzve të mëdhenj dhe karaktereve të vogla, përfitimeve të thella dhe marrëdhënieve të cekëta. Është koha e dy të ardhurave, por më shumë divorce, shtëpi të zbukuruar, por familje të shkatërruara. Është koha ku ka shumë në dritaren e ekspozitës, dhe asgjë në magazinë.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Familja fisnike Xhixho e Suhës në Gjirokastrë

Në kuadrin e 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, Familja Xhixho nga Suha e Gjirokastrës, e cila i dha Atdheut djalin e saj: dëshmorin Pano Xhixho, si dhe kuadrot: gjeneral Thoma Xhixho, Kristaq Xhixho, Vasil Xhixho dhe Foto Xhixho, përsëri pasardhësit: Piro e Sokol Xhixho, bënë të mundur daljen në dritë të Historikut të Brigadës XIX Sulmuese (BrXIXS). Një përvojë dhe një shembull prej kësaj familje, se si mund dhe duhet të kontribuohet për Atdheun, për të pasqyruar historinë e lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Me ndjenjën e krenarisë dhe të sakrificave të bëra në luftë, pasardhësit dhe më i riu Besian Xhixho, që prej SHBA-së, në hyrje të historikut shkruajnë: “Për dëshmorët e Brigadës XIX Sulmuese, për partizanët dhe partizanet e kësaj brigade. Gjithashtu, për ata drejtues e udhëheqës në radhët e UNÇSH-së, që shkulën brinjë nga merita, egoja dhe lavdia e tyre personale, duke i bërë ato gurë e tulla pa emër për themelet dhe ngrehinën e shtetit shqiptar; e i hodhën si qymyr, zjarr, ajër e hi në furrën ku gatitej çeliku i parzmores së historisë së luftës së popullit tonë për mbijetesë, liri, pavarësi dhe dinjitet”.

Një mesazh që përsëritet nga brezi në brez prej kësaj familje të madhe atdhetare, e cila në histori hyri si një bazë e fuqishme e antifashizmit shqiptar në vitet e zymta të pushtimit të vendit, por që kontribuoi me shpirt për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut. Sot ajo është krenare për rrugën e ndjekur nga të parët e saj dhe pasardhësit po bëjnë çmos që të pasqyrojnë me saktësi dhe me dokumente historinë e njërës prej formacioneve më të lavdishme të asaj ushtrie partizane të lavdishme që luftoi për popullin dhe i dha lirinë.

Siç ka vënë në dukje H. W. Tilman se: “Historia e Shqipërisë është një rekord i pathyer pushtimesh, shtypjeje, dhe keqbërjeje nga turqit, grekët, austriakët, italianët, serbët, bullgarët, dhe gjermanët. Pak vende mund të jenë kaq të dërrmuara dhe kaq të ballafaquara me shtypjen në duart e fqinjëve më të fuqishëm, dhe prapë të kenë ruajtur të pathyer vullnetin e tyre për pavarësi siç kanë bërë shqiptarët për 500 vjet, që nga koha kur Skënderbeu, heroi i tyre i madh kombëtar, korri i pari sukses ndaj turqve osmanë”.

Antifashizmi, motivi kryesor i brigadës së vëllazërimit

Historiku i BrXIXS i shkruar nga një komision me kryetar gjeneralmajor Thoma Xhixho, është shkruar vite më parë, ka parë dritën e një botimi të thjeshtë në vitin 2000. Duke ruajtur me korrektësi punimin e historikut, përsëri ai përbëhet prej tre krerësh: Kreu i parë përfshin veprimtarinë luftarake e politike të reparteve partizane para formimit të brigadës, në zonën Konispol-Delvinë-Dropull, në periudhën mars-nëntor 1943. Kreu i dytë përfshin formimin e Grupit IV Partizan “Çamëria” (GrIVP), ku përshkruhen luftimet në Libohovë, Dangëlli, në Konispol dhe në zonën e Vurgut, etj. Kreu i tretë organizimi, përbërja dhe veprimet luftarake të BrXIX, operacionet për çlirimin e Konispolit, të Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës, etj.

Historiku i BrXIXS përshkruan rrugën luftarake të këtij formacioni, duke na dhënë faqe të lavdishme të historisë së Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare të organizuar dhe të udhëhequr nga PKSH në luftën kundër ushtrive pushtuese nazi-fashiste dhe tradhtarëve të vendit për liri, pavarësi e çlirim shoqëror, për vendosjen e pushtetit të demokracisë popullore.

Historiku paraqet në detaje formimin dhe të gjithë veprimtarinë luftarake të BrXIXS me veçoritë e saj specifike. Brigada u formua mbi bazën e GrIVP “Çamëria” dhe të gjithë veprimtarinë e saj luftarake e zhvilloi në zonën Konispol, Sarandë, Dropull, në pjesën bregdetare dhe bashkëveproi ngushtë me forcat e Zonës së Parë Operative (ZIOp).

Brigada XIX Sulmuese, historiku i vlerave të veçanta të njësisë ushtarake të LANÇ-it

BRIGADA XIX SULMUESE HISTORIKU

LUFTA ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE

Si rregull brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH) u formuan nga partizanë, çeta e batalione partizane nga krahina të ndryshme të vendit, ndërsa kjo brigadë, si vijuese e traditave të mira dhe luftarake, u krijua me luftëtarë të GrIVP që ishin në territorin e tyre. Partizanët dhe kuadrot e saj ishin luftëtarë me përvojë të fituar në njësitë luftarake, në çeta dhe në batalione partizane, si dhe në formacionin e veçantë si të GrIVP “Çamëria”, me një përvojë dhe traditë luftarake në mjaft aksione e beteja të zhvilluara në zonë.

Efektivi i brigadës përbëhej nga partizanë shqiptarë dhe partizanë minoritarë grekë nga fshatrat e Konispolit, Dropullit, të Vurgut e të Pogonit, duke e quajtur këtë njësi, brigadë të vëllazërimit midis popullit shqiptar dhe minoritar grek; vëllazërim ky i mbrujtur e i çimentuar me gjak në luftën kundër pushtuesve të huaj e tradhtarëve të vendit.

Repartet e brigadës në çdo situatë dhe kohë zbatuan direktivat e Partisë Komuniste dhe të Komandës e të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, si dhe bashkëveprouan me repartet e ELAS-it në luftë kundër armikut të përbashkët dhe dhanë një kontribut të dukshëm në vëllazërimin e popullit shqiptar me popullin grek.

Një historik për t'u marrë si model

Në historikun e BrXIXS pasqyrohen dokumente të Arkivit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare (AQPPSH), të Arkivit Qendror të Ushtrisë (AQFA), Arkivit të Qarkut të Gjirokastrës, si dhe kujtime të ish-partizanëve e kuadrove të brigadës. Kontribut të veçantë kanë dhënë me kujtime e shënime dhe luftëtarët kuadro Pipi Mitrojorgji, Petrit Islami, Vasil Nika, Fadil Meleqi, Foto Papaj, Thoma Budri etj.

Përgatitja e Historikut të BrXIXS nga Komision filloi në vitet



“PËR DËSHMORËT E BRIGADËS XIX SULMUESE, PËR PARTIZANËT DHE PARTIZANET E KËSAJ BRIGADE. GJITHASHTU, PËR ATA DREJTUES E UDHËHEQËS NË RADHËT E UNÇSH-SË, QË SHKULËN BRINJË NGA MERITA, EGOJA DHE LAVDIA E TYRE PERSONALE, DUKE I BËRË ATO GURË E TULLA PA EMËR PËR THEMELET DHE NGREHINËN E SHTETIT SHQIPTAR; E I HODHËN SI QYMYR, ZJARR, AJËR E HI NË FURRËN KU GATITEJ ÇELIKU I PARZMORES SË HISTORISË SË LUFTËS SË POPULLIT TONË PËR MBIJETESË, LIRI, PAVARËSI DHE DINJITET”.

1968-1971, vijoi më tej në vitet 1974-1977, duke marrë dhe mendimin e Komiteteve të Veteranëve të LANÇ-it të rretheve Sarandë e Gjirokastrë, për të përfunduar në vitet 1980-1984 edhe nën kujdesin e Akademisë Ushtarake (AU). Punimi i fundit ishte në periudhën gusht 1999-maj 2000, kur edhe pa për herë të parë dritën e botimit.

Në botimin e dytë të Historikut të BrXIXS, viti 2024 është ruajtur tërësisht materiali i botimit të parë. Janë bërë disa korrigjime për t'u përshtatur në kohën dhe në fjalorin e përdorur të termave ushtarak, janë bërë shkurtime dhe shkurtesa, shtuar në historik këndi i dëshmorit

me të dhënat e gjetura për çdo dëshmor e foto të tyre, janë bërë disa skema të reja të luftimeve, është bërë plotësimi me të dhëna të plota për dëshmorët e brigadës, për listën e partizanëve, si dhe të literaturës së përdorur në historik.

Botimi i dytë i librit “Brigada XIX Sulmuese, historiku” është përgatitur për botim nga studiues ushtarak, të cilët kanë pasqyruar momentet më kryesore të luftimeve, vendosjen e forcave, idenë e të dy palëve luftuese, dinamikën e zhvillimit të luftimeve, si dhe gjendjen e forcave pas përfundimit të luftimeve.

Libri jep të dhëna të dokumentuara të formacioneve luftarake të kësaj njësie sulmuese, të dhëna për mjaft kuadro drejtues, si dhe vendet e luftimeve dhe të rënies së dëshmorëve të këtij formacioni luftarak. E reja e këtij historiku është saktësimi i plotë i emrave të dëshmorëve, por edhe i efektivit të partizanëve pjesëmarrës në këtë formacion luftarak.

Redaktori dhe korrektori i librit Besan Xhixho, nipi i gjeneral Thoma Xhixhos, ka punuar me mjaft kujdes dhe me përkushtim, duke prurë një punim në kohë dhe me një gjuhë të pastër dhe të mbështetur me një fjalor të terminologjisë ushtarake. Ky është dhe një nder që nipi ka bërë për gjyshin dhe formacionin luftarak që ai ka drejtuar.

Familja Xhixho edhe këtë radhë, pas botimit të librave “Gjeneral Thoma Xhixho, i pari komandant i Akademisë Ushtarake Shqiptare” dhe “Koncepte për Artin Usharak”, me punimet teorike dhe praktike të gjeneralit, përsëri bëri të mundur për të parë dritën e botimit historiku, me shpenzimet familjare. Është një rast që duhet vlerësuar e përgëzuar nga shoqëria dhe shteti.

Familje të tilla i bëjnë nder vendit dhe lënë gjurmë me vlera për sot dhe për të nesërmen.

Maji i pranverave të hidhura

Maj 1914.....

17 maj 1914

Kryengritësit, të udhëhequr nga Haxhi Qamili dhe Musa Qazimi me thirrjet “Dum Babën”, shpartallojnë tek Ura e Limuthit në afërsi të Tiranës një grup vullnetarësh tiranas dhe kosovarë, të cilët po shkonin në Shqipërinë e Jugut, për të luftuar kundër forcave vorio-epiriote, që kishin pushtuar Shqipërinë e Jugut.

18 maj 1914

Grumbuj fshatarësh të egërsuar marrin Shijakun dhe drejtohen drejt kryeqytetit, Durrësit. Kryengritësit dalin haptazi kundër Princ Vedit dhe regjimit të tij pro-perëndimor.

19 maj 1914

Princ Vidi dha urdhër të arrestohej Esat Pashë Toptani me akuzën e përfshirjes në organizimin e kryengritjes. Esat Pasha reziston dhe me ndërhyrjen italiane largohet nga vendi.

28 maj 1914

Princ Vidi i jep urdhër Turhan Pashë Përmetit të formojë kabinetin e ri qeveritar. Ndërkohë kryengritësit, duke mos marrë dot Durrësin, nisen drejt qyteteve të tjera. Durrësi qëndron nën një rrethim të ashpër.

Maj 1924.....

1 maj 1924, në Vlorë bëhet varrimi i Avni Rustemit

Varrimi i tij kthehet në një manifestim të opozitës kundër Ahmet Zogut. Nga aty Fan Noli bën thirrje për gjetjen e vrasësve të tij.

2 maj 1924

Një grup ushtarakësh të quajtur “Klika” dhe deputetët e opozitës organizojnë një mbledhje në kinemanë e Vlorës, ku marrin pjesë 300 përfaqësues nga krahinat e vendit dhe anëtarë të shoqërisë “Bashkimi” që ishte krijuar nga Avni Rustemi. Mbledhja i dërgoi dy ultimatumë qeverisë, në të parin dënohej vrasja e Avni Rustemit dhe kërkohej gjetja e vrasësve të tij, dhe në të dytin protestohej kundër Ceno Bej Kryeziut (kunat i Ahmet Zogut), i cili konsiderohej nga opozitarët si agjent serb që u shërbente Beogradit dhe forcave të brendshme të djathta.

5 maj 1924

Shoqëria “Bashkimi”, e krijuar nga Avni Rustemi, i drejton nga Vlorë dhe jo nga Tirana, rinisë shqiptare, një thirrje për kryengritje të armatosur ndaj qeverisë. Deputetët e opozitës braktisin parlamentin dhe deklarojnë se do të rikthehen vetëm nëse seancat do të zhvillohen në Vlorë! Ata e justifikojnë këtë gjë duke thënë se Tirana ishte bërë e pa sigurt nga mercenarët e Zogut.

16 maj 1924

Ngrihet kundër qeverisë garnizoni i Shkodrës me në krye Rexhep Shalën, i cili do të bëhet ministër në qeverinë e re.

24 maj 1924

Fillojnë veprimet e armatosura. Bajram Curri sulmon Krumën, qendër e Prefekturës së Kosovës (Kukësit). Pas një lufte të ashpër Komandanti i Xhandarmërisë Muharrem Bajraktari, me urdhër të Zogut tërhiqet. Curri merr Krumën por nuk guxon të sulmojë Kukësin, aty ku ndodhet Bajraktari.

26 maj 1924

Ngrihet kundër qeverisë garnizoni i Përmetit me në krye Kasem Qafëzezin. Në Vlorë ngrihet një komision për të drejtuar rebelimin. Në veprimet ushtarake komisioni caktoi në Veri, Bajram Currin e Rexhep Shalën kurse në Jug, Kasem Qafëzezin.

27 maj 1924

Shefqet Vërlaci, beu më i madh i vendit dhe njëkohësisht kryeministër i vendit jep dorëheqjen.

Në krye të qeverisë vjen Iliaz Vrioni, i cili fillon bisedimet me opozitarët por bisedimet dolën pa sukses. Si rezultat qeveria cakton Ahmet Zogun për të shtypur Revolucionin.

31 maj 1924

Revolucioni ashpërsohet. Kryengritësit i afrohen Tiranës.

Maj 1997....

4 maj 1997

Rritet bilanci i viktimave. Me dhjetëra vriten në Shkodër, Berat, Tiranë dhe Durrës.



10 maj 1997

Forcat Speciale luftojnë me bandat e armatosura në Gramsh. Afro 100 persona të armatosur i kundërvihen shtetit. Komitetet ushtarake të Beratit pengojnë shpërndarjen e gazetave në qytet.

11 maj 1997

Grabiten dhe vriten pasagjerë në Qafë-Mali në Kukës. Intensifikohet krimi në Vlorë.

14 maj 1997

Sulmohet pika kufitare e Kakavijës. Mbetet e bllokuar rruga Berat-Lushnje. Sulmohet posta në Berat.



15 maj 1997

Shpërthen një depo në Gjirokastrë, duke lënduar 14 persona dhe vrarë 4 të tjerë. Vritet një familje e tërë prej 5 personash në Pogradec.

19 maj 1997

Vazhdon dhuna në Jug të vendit. Tentohet shpërthimi i urës së Kardhiqit në Gjirokastrë. Vazhdojnë vrasjet në Vlorë. Në Memaliaj policia dhe komiteti i shpëtimit bashkojnë forcat kundër njëres prej bandave të qytetit.

21 maj 1997

Vazhdon sulmi kundër urave në Gjirokastrë. Vazhdon situata e rënduar në Sarandë, Vlorë, Shkodër dhe Durrës.

23 maj 1997

Në Cërrik, bandat e qytetit sulmojnë një autobлиндë të forcave speciale. Bilanci: 6 efektivë të forcave speciale të vrarë nga sulmet me granata, 3 të tjerë të kapur peng. Cërriku është qyteti më i afërt me kryeqytetin që ndodhet nën pushtetin e bandave.

24 maj 1997

Në Cërrik një bandë e armatosur kontrollon gjithë qytetin. Shkollat janë të mbyllura.

26 maj 1997

Një bandë me inicialet N.M.T. kërcënon tregtarët e qytetit të Kukësit.



(Herezia e vitit të mbapshhtë)

27 maj 1997

Digjet biblioteka e Kurbinit. Sulmohet një makinë policie në Vlorë.

29 maj 1997

Plaçkitet bashkia e Tepelenës nga njerëz të panjohur.

31 maj 1997

Banda të armatosura terrorizojnë qytetarët e Cërrikut.

Materialet janë marrë nga shtypi i kohës. Çdo ditë e atij viti “të mbapshhtë” ishte e mbushur me kronika drithëruese. Viti 1997, ishte viti që mbolli tmerr, ankth dhe dëshpërim tek çdo familje shqiptare.

Maji, muaji kur rilind jeta mbi tokë, në kohëra të ndryshme historike ka lënë gjurmë dhe vragë, të cilat shënjojnë rrugëtimin tonë si komb, drejt demokracisë, por jo pa kosto.



"Tre zemra, një flamur, tre njerëz të një ideali, tre pushkë e një luftë, tre zemra për një atdhe..."

Heroi i Popullit Fuat Mero (Babani) lindi në vitin 1917, në fshatin Baban të Devollit, në gjirin e një familjeje atdhetare. Ai u edukua me ndjenjat patriotike. Këtë edukatë e mori që në bankat e shkollës në katundin e tij Baban. Mbas mbarimit të fillores dhe të Shkollës Mashkullore në Korçë, u regjistrua në Liceun e atij qyteti. Sa më shumë rritej aq më i ditur bëhej. Në atë kohë filloi të lexojë libra përparimtare të kohës e fletushka të nxjerra antizogiste etj.

Zemërimi popullor i shpërtheu me pjesëmarrjen e tij në demonstratën e bukës të 21 shkurtit 1936, në qytetin e Korçës. Ai u bashkua me punëtorët, studentët e liceut e nxënës të shkollave të tjera të qytetit. Aty në kohën e të revoltuarve që thërrisnin "duam bukë" bashkohej edhe zëri i Fuatit. Në vitin 1938, ai bëhet anëtar i grupit antifashist të konviktit. Në këtë kohë Grupi Komunist i Korçës e ngarkoi Fuatin të merrej me grupin edukativ të shkollës. Më pas Fuati pranohet anëtar i Grupit Komunist të Korçës. Detyra iu vu të zhvillonte biseda me popullin si në qytet ashtu edhe në katundin e tij në Devoll. Ai bisedonte dhe u shpjegonte të gjithë njerëzve të të gjithë moshave e profesioneve, se cili ishte regjimi i Zogut dhe i fashizmit.

Në ditët e para të prillit 1939, kur u mësua se Italia fashiste do të sulmonte Shqipërinë, ai ishte në krye të listës së liceistëve për të luftuar me armë, por ai bëri veshin e shurdhër. Më datë 4 prill 1939, Fuati u rreshtua i pari në demonstratën e organizuar nga grupi Komunist i Korçës. Protestuesit thërrisnin "duam armë"; "poshtë fashizmi"; "nuk lëshojmë asnjë pëllëmbë tokë". Aty mësoi se Shqipëria ishte tradhtuar nga vetë mbreti Zog.

Në vjeshtë të vitit 1939, Fuat Babani shkoi për studime në Itali, Romë, në Fakultetin e Inxhinierisë Industriale. Të drejtën e studimit e fitoi në sajë të rezultateve të shkëlqyera në lice. Ai si student në Itali, nuk pranoi e nuk veshi asnjëherë uniformën fashiste kur jepte provim. Profesori i fizikës kur disa shokë u kthyen për të vazhduar universitetin në Romë, pyeti: – Ku është student Fuat Mero, pse nuk ka ardhur?, – ata i thanë: – Ana ekonomike. – Jo, unë do ta ndihmoja ekonomikisht. Ai student do t'i vlejë Shqipërisë! Kjo sepse në vitin 1941, Fuati bashkë me një grup shokësh student, u kthye në Shqipëri për të vazhduar luftën kundër fashizmit.

Më 8 nëntor 1941, Fuat Mero (Babani), u pranua anëtar i PK-së, ai ishte një nga 200 të parët e krijimit të saj. Me të mbërritur në Atdhe, Fuati punoi në Devoll, debutoi në celulën e Progrit dhe punoi për të ngritur fshatarët në luftën çlirimtare. Në Devoll ai krijoi disa grupe edukative e guerile si dhe disa grupe aktiviste me të rinj. Natën e 24 orrikut 1942, Fuati ishte në krye të aksionit të prerjes së linjave telefonike. Në Devoll vazhdoi të militojë deri sa Qarkori i Korçës zbuloi disa të dhëna se Fuati do të arrestohej nga kuestura dhe porositi që ai të bashkohej sa më parë me çetën partizane në Moravë-Devoll, e aty të merrte edhe drejtimin e saj. Çeta partizane në Devoll nën udhëheqjen e Fuat Babanit si komandant, të Raqi Themelit si komisar e të ish-komandantit të çetës Jorgo Plaku, u hodh në aksione të hapura.

Gjatë gjithë kohës ai u dallua si luftëtar trim dhe komandant i zoti. I pari aksion i kësaj çete ishte vrasja e dy milicëve në katundin Gjyres. Pastaj në dimrin e viteve 1942-1943, njëra pas tjetrës u çarmatosën postat e kufirit në Braçanj, Bozhigrad e Cerje. U hapën kosheret e drithit të bejlerëve e agallarëve e bereqeti iu shpërnda popullit fukara. Fuat Babani u dallua për aftësinë e organizimit dhe komandant me talent, gjakftohtë dhe me gjykim të madh që orientohej në situatë të vështira e të papritura. Emri i tij u bë shembull frymëzimi në tërë Devollin e zonën e Korçës. Punoi dhe luftoi që të hidhte në luftë kundër fashizmit gjithë popullin, pa dallim feje dhe ideje.

Ai me shokët e çetës u mor dhe me krijimin e Këshillave NÇ në shumë fshatra të Devollit. Fjala e tij ngjiste si me zamkë në mendjen e devollitëve. Dëgjonte shumë dhe fliste pak. Kështu çeta e Moravës, e udhëhequr nga komandanti Fuat Babani, në dimrin e viteve 1942-'43, e shndërroi zonën e Devollit në një bazë të fuqishme të luftës partizane. Aksioni më i rëndësishëm për çetën partizane deri në mars 1943, ishte ai i datës 20 shkurt 1943, në Pojan të fushës së Korçës, ku fashistët pësuan një disfatë të plotë, duke lënë në çdo



qoshe shtëpie e rrugë trupa të vrarë e të plagosur, midis tyre dhe një oficer. Armiku i ndoqi me artileri dhe avionë bombardues dhe i mitralonte e i bombardonte sa herë që i diktonte në udhëtim e sipër. Gjatë këtij aksioni çeta nuk pati asnjë të vrarë dhe të plagosur.

Më datë 6 mars 1943, ajo nga mali Moravës u ul në fshatin Hoçisht.

Pushtuesit fashistë e tradhtarët e vendit, për të shuar lëvizjen antifashiste në zonën e Devollit dhe për t'u hakmarrë pas Pojanit, vendosën të bënin gjithçka që ta asgjësonin çetën partizane. Më 6 mars 1943, Komanda Fashiste e Bilishtit, e ndihmuar nga spiunët, u informua se partizanët ishin vendosur në Hoçisht. Për tërë natën, fashistët e ballistët përgatitën forca, rreth 700 vetë me të gjitha llojet e armëve dhe i nisën për Hoçisht me porosi që më parë të bënin rrethimin e fshatit. Dhe ashtu bënë, rrethuan fshatin Hoçisht nga të gjitha anët, duke zënë tërë kodrat e qafat.

Ata kishin llogaritur që me zjarrin e mitralozave të lehtë e të rënde të asgjësonin çetën si dhe një pjesë të tyre donin t'i zinin gjallë. Komanda e Çetës, sapo u informua, orientoi partizanët të çaheshin nga dy drejtime. Disa skuadra, pa zbardhur dita, nëpërmjet lumit, dolën sipër malit të Moravës, të tjerët nga Qafa e Shëndëllisë. Kurse Fuati vetë, bashkë me shokun e tij Demir Muharrem Progrin e përgjegjës in e rinisë Avdulla Progrin, nëpërmjet një përroi, morën përpyetë Qafës së Shëndëllisë dhe pasi u ngjiten afër një shkëmbi të mbuluar me dëborë, zunë pozicion. Më sipër shkëmbit, fashistët

nxinin si re të zeza. Dëbora zbardhte në çdo anë.

Qëllonin fashistët, qëllonin partizanët. Lufta filloi e ashpër. Fuati me dy shokët, filluan të qëllonin të parët në drejtim të tyre e pastaj edhe të tjerët. Plumbat u vinin si breshër. Nga plumbat që vinin nga të tërat anët, u plagos Demiri, pastaj Fuati. Avdullahi mundahej t'i ndihmonte, t'u lidhte plagët, por nga breshëritë edhe ai ra përdhe. Fuati, duke parë se dy shokët e tij iu vranë dhe vetë nuk kishte shpëtim, vendosi të asgjësonte, duke i djegur dokumentet bashkë me listën e shokëve të Çetës dhe bazave të saj në Devoll. Kështu duke luftuar, të tre djemtë dhanë jetën, duke mos iu dorëzuar armikut, i cili vazhdonte të bënte thirrje: "partizanë, dorëzohuni...". Të tre partizanët vdiqën pranë njëri-tjetrit me grushtet shtrënguar.

Humbja e Fuat Babanit, Demir Muharrem Progrit dhe Avdulla Progrit, shkaktoi hidhërim të thellë në radhët e çetës partizane dhe të popullit të Devollit. Në një trakt të Qarkorit të Korçës thuhej: "... vdiqën si heronj ata tre të rinj. Tre zemra, një flamur, tre njerëz të një ideali, tre pushkë e një luftë, tre zemra për një atdhe...". Për ta bërë të pavdekshëm emrin dhe veprën e komandantit të Çetës, në maj 1943, batalionit të devollit iu vu emri "Batalioni Fuat Babani", sepse çeta tashmë ishte bërë nga 7 vetë në krijimin e saj, në një njësi të madhe, batalion, e ndarë edhe në disa kompani. Të gjithë ishin djem nënash nga Devollit. Fuat Shaban Meros, pas vdekjes iu dha titulli i lartë: "Hero i Popullit".



PËR TA BËRË TË PAVDEKSHËM EMRIN DHE VEPRËN E KOMANDANTIT TË ÇETËS, NË MAJ 1943, BATALIONIT TË DEVOLLIT IU VU EMRI "BATALIONI FUAT BABANI", SEPSE ÇETA TASHMË ISHTE BËRË NGA 7 VETË NË KRIJIMIN E SAJ, NË NJË NJËSI TË MADHE, BATALION, E NDARË EDHE NË DISA KOMPANI. TË GJITHË ISHIN DJEM NËNASH NGA DEVOLLI. FUAT SHABAN MEROS, PAS VDEKJES IU DHA TITULLI I LARTË: "HERO I POPULLIT".

Inxhinier Ymer Bejko, partizani - skënderbegas që la gjurmë në Flotën Luftarake Detare të Shqipërisë

Ymer Bejko lindi në vitin 1929, në lagjen Dunavat të Parë, Gjirokastrë, në një shtëpi karakteristike, në fasadën e së cilës ka dy luanë, zbukurime të tjera, me mjedis të gjelbëruar dhe me pozicion nga ku sodit qytetin e gurtë muze. Vjen nga një familje patriotë e punëtore në breza. Stërgjyshi tij Vesel Efendi Bejko ishte shok me Ismail Qemalin, i vlerësuar dhe nga Bajo Topulli. Kur u mbyllën shkollat shqipe në vitet 1909-1912, e ktheu shtëpinë e tij për shkollimin e rinisë. Ai u ftua dhe mori pjesë në Kuvendin e Pavarësisë në Vlorë. Ymeri ka dy vëllezër veteranë, njëri nga të cilët partizan, oficer Ymeri është nderi i organizatës së veteranëve.

Sevo Tarifa shkruan për kolonel Ymer Meto Bejkon: “Vitet vraponin. Njohja zgjerohej. E pashë në rresht, pionier partizan 15 vjeçar, në Brigadën VI Sulmuese. Ende pa hequr briskun në faqe. Djalosh dinamik. Me gjatësi sa pushka që mbante në sup. Me faqe që i skuqnin si ylli që kishte në bustinë. I flisnin dhe sytë. E ngacmova me një pyetje: ‘Ymer, si të pranuan, ti je i vogël?’. Më pa në sy dhe me buzëqeshjen e tij të trëndafiltë më tha: ‘I vogël është dhe floriri, por kushton shtrenjtë! Pushkën di ta përdor’. Dhe e puthi në tytë!


Djalë i zgjuar. I mprehtë. I sjellshëm. Fytyrëmbël. Zeshkan. Sy patrembur. I urtë. I dalluar në luftime. Plumbit nuk i bënte dredha. Korrekt në llogore, me bashkëluftëtarë, me jetën partizane, me zbatimin e detyrave të kohës, me shembullin e mirë në kapërcimin e vështirësive të situatave të ndryshme të luftës, sidomos me vullnetin, përkushtimin, guximin dhe vendosmërinë për në vijën e parë të sulmit kundër pushtuesit fashist italian. Pushkën e mbante të pastër. I kontrollonte shkëlqimin e vjaskave të tytës....

Pas çlirimit do ta shihja skënderbegas. Ecte me hap. Trupdrejtë. Kryelartë. Përshëndeste të njohur dhe e përshëndetnin. Një shëtitje bashkë në Sheshin “Çerçiz Topulli”. Ishe me leje dhe çmallej me qytetin dhe me shokët moshatarë. Pashë Qazim Tuqin që zbriti nga makina dhe e takoi, e përqafoi, e uroi. Kalimtarët e shikonin. I tërhiqte uniforma, që e zbukuronte më shumë. Shiriti i kuq i pantallonave të jepte përshtypjen e një “gjenerali” trupvogël. Sytë e fëmijëve shkollarë në Qafën e Pazarit dhe në rrugët e rrugicat me kalldrëm të qytetit drejtoheshin te skënderbegasi, pak më i rritur se ata. Ymeri, nxënës i shkëlqyer në mësimet e në shërbime ushtarake. Mbaroi shkollën e mesme dhe u diplomua. Po tani? Një surprizë... Ju komunikua se do dërgohet në ish-Bashkimin Sovjetik për studime ushtarake detare, për inxhinier anijesh, në degën arkitekturë-konstruksion, për projektim ndërtim e riparim të nëndetësve dhe anijeve të mbiujshme. ...Mbaroi akademinë për shtatë vjet dhe u kthye në Shqipëri krenar. Uniforma e skënderbegasit u zëvendësua me atë të marinarit. E bukur edhe kjo. Korrik 1955.

Fillon punën kryeinxhinier në Flotiljen Ushtarake Detare në qytetin bregdetar të Durrësit. Gjithë gëzim dhe zell. Me forca mendore, fizike e morale. Cilësore. Binte në sy dashuria për punën e re. Këtu drejtonte dhe punimet në kantierin e vogël për sektorin e tij. Fillim i mbarë. Sukseset e para. Pas Flotiljes për nevoja të vendit transferohet në kantierin detar dhe pedagog në Universitetin e Tiranës, dega e inxhinieri-ndërtimit. Me zmadhimin dhe zhvillimin e Flotës, Ymeri me transferimin e komandës së Flotës në Vlorë, emërohet në detyrë shefi i degës së riparim armatimit (kryeinxhinier).

...Pas prishjes së marrëdhënieve me sovjetikët mbajti qëndrim të dejtë atdhetar. Mori pjesë me grupin e riparimit të nëndetësve, bashkë me kinezët. Me përrurimin e kantierit të riparimit të anijeve në Pashaliman, po me shokët kinezë, në detyrën e shefit të byrosë teknologjike dhe teknologut të repartit të stafit, në vartësi kishte dokun lundruar, shkallën dhe laboratorin e analizave, merrte pjesë në riparimin kapital të katerave silurues. Dha një ndihmesë të madhe në zhvillimin e vrullshëm të FDL.

Detyrën për nxjerrjen e dokut lundruar në shkallë, në vitin 1971, kinezët nuk e morën përsipër. Këtë detyrë si për studim, llogaritje dhe projektim, e mori përsipër dhe i doli për zot inxhinier Ymeri, duke i realizuar me shumë sukses dhe para kohe të parashikuar. Kjo arritje kishte rëndësi të madhe, sepse siguroi autonominë, nëndetëse dhe vlera të mëdha valutore. Për këtë kontribut të jashtëzakonshëm, ai u propozua nga kolektivi për çmimin e Republikës të Shkallës së Parë. Në vizitën që bëri ish-ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku, pa nga afër punimin e riparimit kapital të dokut lundruar dhe vlerësoi lart rolin e



Ymerit për realizimin e një nga detyrave më të mëdha në ushtri.

Në vitin 1976 Ymeri, si inxhinier i aftë dhe i talentuar, mori përsipër nxjerrjen në shkallë të anijes cisternë “Patosi” për riparim kapital. Kjo anije ishte me peshë mbi kapacitetin e shkallës. Për këtë nevojiteshin studime e llogaritje dhe me projekte të veçanta. Këtë detyrë të madhe për ushtrinë, Ymeri e realizoi me shumë sukses dhe për herë të dytë u propozua për “Çmimin e Republikës të Shkallës së Parë”, por këto dy propozime i mbuloi burokratizmi si gjarpri vezët, mbetën në sirtarët e Ministrisë së Mbrojtjes. Detyrat që ka kryer Ymeri kanë qenë të rëndësishme. Ato kanë dashur punë me orar e pa orar, rendiment dhe cilësi, disiplinë e zgjuarsis, operativitet dhe vendosmëri.

Ymeri, njeri i tokës, i detit dhe i nëndetit! Për figurën e tij më kanë thënë fjalët më të mira bashkëpunëtorë e bashkëkohës te tij me pozita të larta. Detyrat kanë qenë voluminoze. Për realizimin e tyre i është dashur që shpeshherë të mos mblidhej në shtëpi. Në punë “shtronte gunën”, midis njerëzve. Që të përballonte detyrat e kohës dhe rritjen e tyre në perspektivë, është ndihmuar nga bashkëshortja, Lali, një grua e papërtuar, punëtore, gojëmjaltë, e qeshur, e cila është kujdesur veçanërisht për mirërritjen dhe edukimin e tre djemve, njëri më i mirë se tjetri: Arbeni, inxhinier mekanik, martuar me Anilën, mjeke-pediatre, me dy vajza të mrekullueshme, Amandën dhe Enolën për arkitekte; Araniti, teknik i mesëm dhe mjeshtër, martuar me Fatbardhën, me vajzën, Lejla, me arsim të lartë, mbaruar për ekonomi-biznes, djali Fladio mbaruar për elektronikë.

Djali i tretë, Imiri, Inxhinier për kimi-industriale, shumë i suksesshëm në Itali, ku punon, martuar me Morenën, me arsim të lartë, ekonomi-financë, me vajzën Ana, djali Daniel. Këta filiza të familjes “Bejko” janë të dashur, të mirë, të sjellshëm, me rezultate të shkëlqyera në mësimet. Ymeri ka qenë dhe është i rrethuar prej

tyre dhe zemrat rrahin me respekt të ndërsjellë...!”

Yzeir Dervishi, shok që nga fëmijëria i Ymerit, përfshi shkollimin si skënderbegas dhe në ish-Bashkimin Sovjetik, kujton: “Ka 74 vjet njohje e miqësi me Ymer Bjekon, pasi kemi qenë bashkë në shkollën ‘Skënderbej’ dhe bashkë-studentë në Leningrad të Bashkimit Sovjetik. Marrëdhëniet tona të pastra e të sinqerta kanë vazhduar gjatë gjithë jetën. E kështu, do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Ymeri është një shok i mirë dhe mik i sinqertë për të gjithë. Atë e vlerësojnë si një njeri me vlera të larta morale. Bashkëluftëtarët e Brigadës VI Sulmuese “Heroinë e Popullit”, ku ai u rreshtua partizan që më 1 korrik 1944, ruajnë kujtimet dhe konsideratat më të mira për Ymerin. Me fjalë të ngrohta zemre flasin edhe bashkënxënësit e shkollës ‘Skënderbej’, ku ai qëndroi deri në vitin 1948, pasi e dërguan të studionte për inxhinier detar në Leningrad. ...Kudo puna e tij është vlerësuar mirë. Ka qenë inxhinier i talentuar...!”

Duke qenë në pension, Ymer Bejko, i mësuar me punë, nuk mund që qëndronte në rehatllëk e në pasivitet. Ka ruajtur tiparet e njeriut të punës, të veprimtarit shoqëror. Është aktivizuar e aktivizohet sidomos në aktivitete atdhetare e kulturore me organizatën e veteranëve të LANÇ. Ruan modestinë dhe korrektesën, marrëdhëniet shoqërore në Durrës, ku banon prej vitesh dhe në Tiranë, pa u shkëputur dhe me bashkëluftëtarë partizanë, bashkë-studentë, bashkëpunëtorë e bashkëkohës të ish FLD-së. Ka fituar respektin qytetar. Koloneli Ymer Bejko ka lënë gjurmë të thella e kujtime të mira jo vetëm në kolegët e tij, por më gjerë, horizontalisht dhe vertikalisht, në bashkëpunëtorë të bazës e deri në drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes. Në profilin e inxhinierit ka qenë i vetmi i profilizuar në fushën përkatëse në FLD dhe në Ushtri.

Skënderbegas ndër vite

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg foli gjerësisht mbi pyetjet e bëra nga liderë të rinj nga të dyja anët e Atlantikut, ndërsa mori pjesë virtualisht në Samitin e katërt vjetor të Rinisë të NATO-s.

Duke folur para auditorit të anëtarëve të rinj të stafit në selinë e NATO-s në Bruksel, Sekretari i Përgjithshëm e përshkroi sigurinë si thelbësore për përmbushjen e sfidave të mëdha globale, nga ndryshimi i klimës deri te zbutja e varfërisë. Z. Stoltenberg theksoi rëndësinë e investimeve të vazhdueshme në mbrojtje duke pasur parasysh sfidat në zhvillim të sigurisë dhe nënvizoi rëndësinë e qëndrueshme të garancisë kolektive të sigurisë kolektive të Nenit 5, duke nënvizuar se një sulm ndaj një aleati do të konsiderohej si një sulm ndaj të gjithëve. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu iu përgjigj pyetjeve në lidhje me mbështetjen e NATO-s për Ukrainën dhe punën e saj jetike me partnerët në Indo-Paqësor.

Edhe Admirali Rob Bauer, Kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s, foli gjithashtu në Samitin e Rinisë nga Stokholmi. Ai theksoi rëndësinë e kapacitetit individual dhe kolektiv të aleatëve për t'i rezistuar sulmit të armatosur, siç përcaktohet në Traktatin e Uashingtonit, nevojën për të pasur një mentalitet elastik dhe aftësinë për të pritur të papriturën.

Samiti i Rinisë i këtij viti u zhvillua në dy vende, në Miami dhe Stokholm, virtualisht, pavarësisht orës me qëllim që të zhvillohej njëkohësisht në të gjithë Aleancën dhe më gjerë, përfshirë edhe Kievin.

Siguria, thelbësore për përmbushjen e sfidave, rëndësia e investimeve në mbrojtje

Në korrik, NATO do të mbajë Samitin e saj në Uashington dhe do të shënojë 75-vjetorin e Aleancës, por gjithashtu do të trajtojë disa nga çështjet dhe sfidat shumë serioze që shënojnë aktualitetin. Sekretari i Përgjithshëm foli para audiencës të Samitit të Rinisë mbi disa nga kërcënimet kryesore me të cilat përballen aleatët e NATO-s dhe se çfarë po bën Aleanca për t'i zgjidhur ato. Ai tha se NATO përballlet me shumë kërcënime dhe shumë sfida të sigurisë, në një botë me konkurrencë më të madhe të fuqive. Ndërsa përmendi Kinën, ai tha se në krye të sfidave “kemi një luftë të re në Lindjen e Mesme, kemi një luftë të plotë në Evropë me një agresion luftarak brutal të nisur nga Presidenti Putin kundër Ukrainës. Dhe e gjithë kjo ka rëndësi për sigurinë tonë”. Stoltenberg tha se: “Askush nuk mund të thotë me siguri se cila do të jetë lufta e ardhshme, kriza e ardhshme dhe kërcënimi i ardhshëm, por ajo që mund të them është se për sa kohë që ne qëndrojmë së bashku, Amerika e Veriut dhe Evropa dhe mbrojmë njëri-tjetrin, ne do të jemi të mbrojtur dhe të sigurt, sepse së bashku aleatët e NATO-s përfaqësojnë 50% të fuqisë ekonomike të botës dhe 50% të fuqisë ushtarake të botës. Pra, për sa kohë që qëndrojmë së bashku, do të jemi në gjendje të përballojmë çdo kërcënim dhe sfidë të mundshme kundër sigurisë sonë”, - tha ai.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u ndal edhe tek rritja e shpenzimeve për mbrojtjen në një kohë me sfida të mëdha në mbarë globin. Ai tha se pa paqe, pa siguri, ne nuk do të arrijmë të përballojmë asnjë nga sfidat e tjera të mëdha me të cilat përballemi, qoftë ngrohja globale, ndryshimet klimatike apo zbutja e varfërisë apo përparimi social dhe ekonomik. “E gjithë kjo do të jetë e pamundur nëse nuk jemi në gjendje të ruajmë paqen, të ruajmë sigurinë për 1 miliardë njerëz që jetojnë në vendet e NATO-s”, - tha Stoltenberg. “Unë kam qenë ministër i Financave, kam qenë kryeministër për 10 vjet, kam qenë në poste të ndryshme politike për shumë vite. Dhe me të vërtetë e kuptoj se është e vështirë të gesh para për mbrojtje, sepse të gjithë politikanët gjithmonë, dhe unë kam qenë mes tyre, do të donin të shpenzonin para për shëndetësinë, arsimin, ndryshimet klimatike, për të gjitha detyrat e tjera të rëndësishme. Por realiteti është se nëse nuk kemi sukses kur bëhet fjalë për sigurinë, nuk do të kemi sukses me të gjitha detyrat”, - tha ai.

Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë dhe rënies të Murit të Berlinit, por dhe ndërsa tensionet ishin ulur, aleatët e NATO-s reduktuan shpenzimet e tyre të mbrojtjes për shumë vite. Por tani, kur tensionet janë në rritje, aleatët duhet të jenë në gjendje të rrisin shpenzimet e mbrojtjes dhe të investojmë në mbrojtje. Sekretari i Përgjithshëm tha se rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes NATO e ka bërë edhe më parë. “Deri në fillim të viteve 1990, të paktën në fund të viteve 1980, aleatët e NATO-s në Evropë dhe Kanadaja, shpenzuam afërsisht 3% të PBB-së për mbrojtje, që është dukshëm më shumë se sa shpenzojmë sot. Sepse atëherë kemi jetuar në një botë më të rrezikshme dhe më pas kemi investuar më shumë në sigurinë tonë”, - tha ai.

Teknologjia në zhvillim dhe mënyra se si ajo po i jep formë luftës. Marrëdhëniet e NATO-s me vende jashtë Aleancës

Teknologjitë përçarëse në zhvillim po ndryshojnë natyrën e luftës po aq sa bëri Revolucioni Industrial disa shekuj më parë,

Stoltenberg në Samitin e Rinisë së NATO-s 2024: Të formësosh të nesërmen tënde



sepse ne e shohim atë edhe në Ukrainë. Si kibernetika, si dronët, si sistemet autonome, po luajnë një rol shumë të madh në luftën në Ukrainë. Lufta e tyre në llogore, na kujton Luftën e Parë Botërore, por ndërkohë kemi edhe teknologjitë e avancuara të aplikuara për këtë lloj lufte klasike. Sekretari i Përgjithshëm tha se: “NATO ka qenë dhe vazhdon të jetë Aleanca më e fortë dhe më e suksesshme në histori për shumë arsye, por një nga arsyet është se ne kemi qenë gjithmonë në gjendje të mbajmë një avantazh teknologjik ndaj kundërshtarëve tanë të mundshëm dhe ne vetëm duhet të sigurohemi që të ruajmë atë avantazh teknologjik. Ne e bëjmë këtë dhe tani duke investuar më shumë në teknologji, kemi krijuar një fond të ri, Fondin e Inovacionit. Ne kemi krijuar gjithashtu një rrjet qendrash për zhvillimin e teknologjisë në të gjithë Aleancën”, - tha ai. Sekretari i Përgjithshëm tha se e gjithë kjo ishte për shkak të garantimit pjesërisht që NATO si Aleancë, por edhe aleatët si aleatë, të sigurojnë që ata të investojnë në teknologji të reja përçarëse, të cilat janë shumë të lidhura edhe me aftësitë ushtarake, inteligjencën artificiale dhe llogaritjen kuantike dhe se ka shumë rëndësi si do të përftoheshin dhe zhvillohen armët ose sistemet e armëve sot dhe në të ardhmen. Stoltenberg tha se gjithashtu “kemi nevojë për udhëzime etike”. Dhe se NATO është duke punuar për këtë. “Për aleatët e NATO-s, por mbi të gjitha, ne duhet të sigurojmë që jo vetëm aleatët e NATO-s, por edhe kundërshtarët tanë të mundshëm të kenë një minimum udhëzimesh etike kur ata tani zbatojnë të gjitha këto teknologji të ndryshme në sistemet e tyre të armëve”.

Lidhur me partneritetin jashtë NATO-s, Aleanca ka afër 40 vende partnere në mbarë globin, ndërsa lidhur me partnerët në Indo-Paqësor, ajo ka katër partnerë, Japoninë, Korenë e Jugut, Australinë dhe Zelandën e Re. “Këta janë partnerë të rëndësishëm për NATO-n. NATO është një Aleancë rajonale, Amerika e Veriut dhe Evropa dhe NATO do të mbetet një Aleancë rajonale”, tha Stoltenberg. “Neni 5 Klauzola jonë e mbrojtjes kolektive do të zbatohet për aleatët e NATO-s, Evropën dhe Amerikën e Veriut. Por ky rajon, rajoni i Atlantikut të Veriut, përballlet me kërcënime globale. Kibernetike është një kërcënim global. Hapësira, e cila bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për mbrojtjen është një sfidë globale, sigurisht. Por gjithashtu, për shembull, Kina. Nuk ka të bëjë me zhvendosjen e NATO-s në Indo-Paqësor, por ka të bëjë me atë që Kina dhe kërcënimet globale po na afrohen më shumë. Ne e shohim Kinën në hapësirën kibernetike, ne i shohim ato në Afrikë, ne shohim në Arktik, ne i shohim ata duke u përpjekur të kontrollojnë infrastrukturën kritike në vendet tona. Pra, e gjithë kjo ka rëndësi për sigurinë tonë në shumë mënyra”.

Lufta në Ukrainë ndërkohë tregon se siguria nuk është rajonale, siguria është globale. “Vendi kryesor që po i mundëson Rusisë të zhvillojë luftën e saj të agresionit kundër Ukrainës në Evropë, është Kina. Ajo deri tani është partneri më i madh tregtar për Rusinë. Ajo po shpërndan një pjesë kritike për armët e tyre, mikroelektronikën, teknologjinë e avancuar, e cila po i mundëson Rusisë të ndërtojë raketa, drone, etj., gjë që është thelbësore për luftën e saj kundër Ukrainës. Pastaj kemi Iranin dhe sigurimin e

dronëve. Kemi Korenë e Veriut që ofron municion dhe armë. Pra, miqtë e Rusisë në Azi, Irani, Koreja e Veriut dhe Kina, janë kyç për aftësinë e Rusisë për të luftuar kundër mikut evropian, fqinjit të NATO-s”, - tha Stoltenberg. Ideja se mund të ndajmë Azinë nga Evropa nuk funksionon më, tha ai, sepse është e ndërlidhur dhe se ne gjithashtu duhet të adresojmë sfidat e sigurisë që Kina përfaqëson për sigurinë tonë.

Roli i Aleancës së NATO-s në procesin e rindërtimit në Ukrainë pas përfundimit të luftës

Kur u pyet mbi rolin e NATO-s në rindërtimin e Ukrainës pas luftës, Sekretari i Përgjithshëm tha se para së gjithash, duhet të sigurohemi që Ukraina të mbizotërojë, sepse nëse Ukraina nuk mbizotëron, nuk ka asgjë për të rindërtuar në Ukrainën e lirë dhe të pavarur. “Pra, detyra më e menjëhershme, më e rëndësishme tani është të ndihmojmë Ukrainën me mbështetje ushtarake siç bëjnë aleatët e NATO-s dhe NATO-ja. Ne duhet ta mbajmë atë. Ne duhet ta bëjmë mbështetjen më të parashikueshme dhe më të fuqishme, dhe shpresojmë që të marrim vendime për këtë, jo më pak në Samitin e NATO-s, në korrik. Rindërtimi do të jetë shumë i shtrënjtë. Por parandalimi është më i lirë se, në një farë mënyre, riparimi, që do të thotë se çdo raketë e mbrojtjes ajrore që mund t'i ofrojmë Ukrainës do të thotë në fakt më pak dëme, më pak shkatërrim dhe më pak nevojë për rindërtim pas luftës. Ne duhet të jemi në gjendje të ndihmojmë Ukrainën të mbizotërojë, sepse është e rëndësishme për ukrainasit. Por edhe sepse çdo ditë kjo luftë zvarritet, natyrisht, sa më shumë shkatërrim dhe sa më i kushtueshëm, aq më shumë do të jetë burimi i kërkuar për të bërë rindërtim më pas”, tha Stoltenberg. Ai theksoi se parakushti për rindërtim është mbizotërimi i Ukrainës si një komb sovran i pavarur në Evropë dhe se NATO do të luajë një rol kyç në rindërtimin e institucioneve të mbrojtjes dhe sigurisë. NATO do të ndihmojë jo vetëm të rindërtim por edhe Ukraina të bëhet një anëtar i plotë i Aleancës, gjë që u vendos në Vilnius në samitin e verës së kaluar, së bashku me tre vendime të rëndësishme për ta afruar drejt anëtarësimit në NATO. “Ne e kthyem të gjithë procesin nga një proces me dy hapa në një proces me një hap. Ne hoqëm diçka të quajtur Plani i Veprimt të Anëtarësimit. Pra, do të thotë se Ukraina nuk duhet të kalojë përmes Planit të Veprimt të Anëtarësimit; ajo mund të shkojë direkt nga ku është tani dhe të ftohet si një anëtar i plotë. Kështu që ne e shkurtuam procesin”, - tha Stoltenberg. Gjithashtu krijimi i Këshillit NATO-Ukrainë, si një organ i rëndësishëm politik në fakt forcon integrimin politik dhe bashkëpunimin me Ukrainën, dhe gjithashtu bën më të lehtë anëtarësimin në Aleancë në një fazë të mëvonshme. Por edhe programi i madh për ndërveprim, ka një rëndësi të madhe dhe ndërveprueshmëria është një fjalë e vështirë për të siguruar që Ukraina dhe aleatët e NATO-s mund të punojnë së bashku në komunikime dhe operacione, në çdo gjë. Ky program do t'i ndihmojë ata tani, por do t'i ndihmojë edhe në të ardhmen për të ndërtuar një forcë të ardhshme, e cila është plotësisht e ndërveprueshme që mund të integrohet plotësisht me forcat e NATO-s.

Një ekspert spyware australian ka lëshuar një paralajmërim urgjent se përparimet e teknologjisë nënkuptojnë se çdo telefon celular dhe privatësia e pronarëve të tyre, është nën kërcënim. Tristan Wilson, i cili është aq i vetëdijshëm për sigurinë sa kontrollon për kamera të fshehta dhe pajisje dëgjimi, kur qëndron në një hotel, tha që Australianët duhet të bëhen më të vetëdijshëm për kërcënimet ndaj sigurisë dixhitale, veçanërisht në telefonat e tyre.

Z. Wilson, shefi operativ i Grupit Mbrojtës, thotë se në të kaluarën, një person kishte nevojë për akses fizik për të instaluar spyware në një telefon celular, por tani ju duhen vetëm kredencialet e Apple ID të viktimës ose kredencialet e hyrjes në Google Gmail për të pasur akses në pajisje”, - tha ai. “Kanë kaluar ditët kur keni nevojë për qasje fizike në pajisje. Gjithçka mund të bëhet tani përmes mjedisit cloud”.

Njerëz kanë shprehur shqetësime në rastet kur marrin me qira Airbnbs dhe apartamente me shërbime, ku ata mund të qëndrojnë për disa muaj.

“Shpesh gjejmë disa kamera të fshehura që përgjithësisht lihen në kanalet e ajrimit ose në njësinë e ajrit të kondicionuar. Ato mund të jenë mjaft të vogla, me të vërtetë në madhësinë e një kamere me vrima”, - tha ai.

“Ne madje hasim në ato lloj grepash 3M që i gjeni pas dyerve të banjës ku vendosni një peshqir, me një kamerë të vogël me vrima gjithashtu”.

Ai tha se teknologjia e spiunimit tani mund të fshihet lehtësisht në sende shtëpiake shumë normale, të tilla si bankat e energjisë që përdoren për të karikuar telefonat me të cilët mund të kenë kamera të fshehta dhe pajisje dëgjimi në to.

“Shpesh gjejmë porta karikimi USB, që kanë në to disa karta SIM të vogla, të cilat i transmetojnë pamjet një personi që padyshim dëshiron të spiunojë bashkëshortin ose partnerin e tij. Pra, gjëra mjaft shkatërruese.

Ndërsa një mbikëqyrje e tillë sekrete është e paligjshme, zoti Wilson tha se shumica e saj po shitet si softuer i kontrollit prindëror.

Pra, ata nuk dalin me deklaratat se është spyware (ose) “ne ju ndihmojmë të spiunoni partnerin tuaj, ne mund të shohim çdo lëvizje dhe vendndodhje të tyre”, por promovojnë produktin si: Qëllimi i kësaj pajisje spyware është të mbani një sy mbi fëmijët tuaj”.

Shumë shitës me pakicë në internet shpesh i quajnë pajisje të tilla si “kamera dado”, ndoshta për të shmangur faktin se ato janë në të vërtetë kamera spiunazhi dhe kamera të fshehta.



Kanalet e ajrimit dhe njësitë e ajrit të kondicionuar janë vendet më të zakonshme që përdoren për të fshehur kamerat spiune.

“Ato nuk bien në sy dhe tashmë, shpesh herë ato nuk i kanë as dritat e vogla led”, - tha ai.

Ndërsa teknologjia e përdorur për spiunim është përmirësuar, po ashtu është përmirësuar edhe teknologjia e përdorur për të gjetur pajisje spiunazhi. Telefonat modernë kanë kamera vërtet të mira, kështu që ju mund të merrni disa aplikacione mjaft të mira për telefonin tuaj që mund të kërkojnë, në dhomë apo në ambientin ku dyshoni, për çdo lente kamerash. Telefonat nuk janë të mirë, kur bëhet fjalë për gjetjen e gjurmuesve GPS dhe pajisjeve të tjera të tipit Wi-Fi, por ka aplikacione të disponueshme që mund të gjejnë spyware.

Edhe televizorët mund të përdoren për të spiunuar njerëzit, tha eksperti, me televizorë inteligjentë të integruar me llogari online që mund të shikohen në telefonat celularë për të parë se çfarë ka parë një person. Pra, nëse dikush ka qasje në disa nga ato llogari, ekziston gjithmonë mundësia që ato kamera të hapen nga distanca dhe që historiku i internetit të aksesohet gjithashtu.

Njerëzit duhet të kontrollojnë rregullisht pajisjet që janë regjistruar në llogaritë e tyre. Një nga problemet që hasin rregullisht është kur njerëzit qëndrojnë në një dhomë Airbnb ose hoteli dhe hyjnë në llogarinë e tyre premium në YouTube në televizor për të parë video. Por ata shpesh harrojnë të dalin dhe personi tjetër që qëndron në dhomë ka akses falas në llogarinë e personit të mëparshëm.

Z. Wilson tha se ka shenja paralajmëruese për t’u kujdesur që tregojnë se telefoni juaj ka spyware në të, të tilla si përdorimi i të dhënave shtesë, shkarkimi i baterisë ose ngrohja e telefonit pavarësisht se nuk është në dorën e dikujt ose në diell.

“Është e rëndësishme që përdoruesi të ndjekë edhe ndjenjat e tij të brendshme, sepse me këtë lloj softueri, ju mund ta hapni

Telefonat celularë dhe privatësia, nën kërcënim



kamerën nga distanca, mund ta hapni mikrofoni nga distanca dhe kushton 15 ose 20 dollarë në muaj”.

Për të kundërshtuar kërcënimet ndaj pajisjeve, ai rekomandoi përdorimin e softuerit antivirus, por paralajmëroi se “ata nuk do t’ju japin mbrojtje të plotë 100%. Kështu që gjithmonë ia vlen të ndryshoni fjalëkalimet tuaja rregullisht (dhe) gjithashtu të kontrolloni menaxherët e fjalëkalimeve që vijnë me pajisjet Apple dhe Google. Wilson paralajmëroi gjithashtu për hakerat dhe mashtruesit që përdorin portat e karikimit USB në aeroporte dhe hotele për të transmetuar dhe dërguar kodin keqdashës në telefonin e viktimave, i cili më pas mund të përdoret për të hyrë në detaje të tilla si hyrjet e llogarive bankare.

“Siguria e telefonit është vërtet e rëndësishme ... për të ndaluar mashtruesit e përditshëm që të hyjnë në telefonin tuaj dhe të vjedhin identitetin tuaj, zhvatjet (dhe) shantazhet... Nëse e mbajmë telefonin tonë të sigurt, do të mbajë gjithashtu persona të tjerë të padëshiruar jashtë pajisjeve tona”, - tha ai.

10 shenja paralajmëruese që dikush po gjurmon telefonin tuaj

Nëse gjeni aplikacione të panjohura në telefonin tuaj

Nëse në pajisjen tuaj shfaqen aplikacione që nuk i keni parë kurrë më parë, jini dyshues!

Kërkoni hapësirën ruajtëse të telefonit tuaj për të zbuluar nëse ka ndonjë aplikacion që nuk ju kujtohet të keni shkarkuar dhe që mund të maskohet si diçka tjetër. Kujdesuni për çdo aplikacion



që pretendon të jetë legjitim.

A ka nevojë telefoni juaj për karikim më shpesh se zakonisht?

Nëse ka aplikacione që funksionojnë vazhdimisht, bateria e telefonit tuaj do të shkarkohet shumë shpejt.

Nëse vëreni se telefoni juaj po mbaron me një ritëm më të shpejtë se zakonisht, kontrolloni nëse ndonjë aplikacion i përdorur së fundi është përgjegjës.

Telefoni juaj është i nxehtë?

Ashtu si me një bateri që shkarkohet shpejt, nxehtësia e telefonit tuaj është një e dhënë që aplikacionet funksionojnë vazhdimisht në sfond.

Nëse nuk e përdorni telefonin tuaj dhe ai nxehet në prekje,

mund të jetë dikush që ju gjurmon.

Telefoni juaj është i dorës së dytë, apo ju është bërë dhuratë?

“Jailbreaking” ose “rooting” i një telefoni i lejon përdoruesit të shkarkojnë aplikacione që nuk janë të disponueshme në dyqanin zyrtar të aplikacioneve.

Nëse në telefonin tuaj shfaqet “jailbroken” pa pëlqimin tuaj, duke përdorur një aplikacion si “Cydia” në iOS, mund të jetë dikush që nuk ka qëllime të mira.

Nëse dyshoni për këtë, ka aplikacione që mund t’i përdorni për të kontrolluar, si “Root Checker” për telefonat Android.

Nëse blini një telefon të përdorur, këshillohet ta rivendosni pajisjen në cilësimet origjinale të fabrikës.

Sa të dhëna përdor telefoni juaj?

Nëse spyware funksionon në sfond, të dhënat e telefonit tuaj mund të përdoren gjithashtu. Kjo ndodh sepse personi që shikon informacionin tuaj po përdor lidhjen e telefonit tuaj për t’ia dërguar atë. Në një iPhone mund të kontrolloni përdorimin e të dhënave tuaja në cilësimet, duke klikuar në faqen “Të dhënat celulare”.

Për përdoruesit e Android shkoni te Cilësimet > Rrjeti dhe Interneti > Përdorimi i të dhënave. Nga atje është e mundur të identifikohet nëse ndonjë nga aplikacionet tuaja po përdor një sasi jashtëzakonisht të lartë të të dhënave celulare.

Keni provuar ta fikni telefonin?

Aplikacionet spyware mund të ndalojnë telefonin tuaj të fiket në mënyrë që autori të ketë gjithmonë akses në të. Këto aplikacione gjithashtu mund të bëjnë që telefoni juaj të marrë një kohë jashtëzakonisht të gjatë për t’u fikur.

Në vitin 2014, eksperti i teknologjisë Edward Snowden tha se mendonte se NSA mund të dëgjonte mikrofoni e një iPhone edhe nëse ai fiket.

Po në lidhje me sjelljen e pashpjegueshme si p.sh. telefoni juaj ndizet rastësisht? Nëse telefoni juaj po bën gjëra të çuditshme në modalitetin e gatishmërisë, si ndezja ose tingulli pa asnjë njoftim, mund të ketë ndonjë aktivitet të dyshimtë.

I keni kontrolluar mesazhet tuaja të dërguara?

Nëse telefoni juaj po dërgon mesazhe me tekst që nuk i keni shkruar ose dërguar kurrë, mund të jetë dikush që hyn në pajisjen tuaj. Kjo vlen edhe për mesazhet e marra me tekst që nuk i prisnit.

Autorët mund të përdorin aplikacione për të dërguar komanda në pajisje, të tilla si fotografimi i ekranit, dërgimi i emailleve ose nxjerrja e një fotografie.

A funksionon si duhet korrigjimi juaj automatik?

“Keyloggers” është spyware që mund t’i lejojë dikujt të shohë atë që po shkruani në telefonin tuaj.

Nëse jeni duke shkruar dhe vini re se korrigjimi automatik po sillet keq, mund të jetë dikush që shikon mesazhet tuaja.

Si mund ta pastroni telefonin tuaj nëse besoni se dikush po ju spiunon?

Instaloni softuer antivirus; Rezervoni hapësirën ruajtëse të telefonit tuaj dhe më pas rivendoseni atë në gjendje fabrike; Çinstaloni aplikacionet që nuk i njihni; Kur shkarkoni aplikacione, kontrolloni që kompania që i ka bërë ato të jetë e ligjshme; Përditësoni telefonin tuaj me përditësimin më të fundit të sistemit; Hiq çdo abonim mujor që nuk e nje; Mos u jep leje të gjitha aplikacioneve për të gjurmuar vendndodhjen ose përdorimin - bëje këtë vetëm për aplikacionet e nevojshme si hartat.

Bëhuni gati për fluturime në hapësirë! "Aeroplani" prej 1.4 miliardë dollarësh është gati të ngrihet

Aeroplani i parë komercial hapësinor në botë më në fund është gati të ngrihet. Pas më shumë se një dekade në zhvillim, "Dream Chaser" i "Sierra Space", i cili mund të ulet horizontalisht në një pistë si një avion tradicional, ka përfunduar testimin.

Anija do të bëjë udhëtimin e saj të parë në Stacionin Ndërkombëtar Hapësinor (ISS) në orbitën e ulët të Tokës më vonë këtë vit, duke transportuar mbi 7,800 paund (3,540 kilogram) ngarkesë.

Edhe pse ky fluturim i parë do të jetë një mision pa pilot, ai përfundimisht do të çojë astronautë në stacionin hapësinor, njëllor si Crew Dragon i SpaceX.

Së bashku me SpaceX dhe Boeing, Sierra Space është një nga kompanitë e kontraktuara nga NASA një dekade më parë për të dërguar njerëz dhe pajisje në ISS.

Çfarë është "Dream Chaser"?

"Dream Chaser" është një anije kozmike e ripërdorshme e zhvilluar nga firma e Kolorados, "Sierra Space".

I vetmi aeroplan hapësinor komercial në botë, ai është projektuar për të çuar njerëz dhe ngarkesa në hapësirë (veçanërisht në orbitën e ulët të Tokës).

Ai do të bëjë udhëtimin e tij të parë në Stacionin Hapësinor Ndërkombëtar (ISS) në orbitën e ulët të Tokës më vonë, në vitin 2024, pas më shumë se një dekade në zhvillim.

Megjithatë, vetëm "SpaceX" e ka bërë këtë, pasi dy kompanitë e tjera kanë pësuar vonesa frustruese të zhvillimit dhe pengesa të kushtueshme.

"Starliner" i "Boeing-ut" vendosi më në fund të dërgonte astronautë në ISS pak kohë më parë përpara një vonese tjetër të minutës së fundit për shkak të një defekti rakete.

Ashtu si rivalët e tij, "Dream Chaser" i "Sierra Space" do të çojë njerëz dhe ngarkesa në ISS në orbitën e ulët të Tokës, megjithëse nisja e tij e parë më vonë këtë vit do të transportojë vetëm mallra.

Sipas "Sierra Space", e cila është e vendosur në Louisville, Kolorado, "Dream Chaser" sapo ka përfunduar testet 'rigoroze' në objektin e testimit të NASA-s "Neil Armstrong" në Sandusky, Ohio.

Këto përfshijnë teste intensive të dridhjeve dhe goditjeve që simulojnë kushtet gjatë nisjes dhe ekspozimet ndaj temperaturave ekstreme tipike të mjedisit hapësinor.



Së shpejti do të dërgohet në Qendrën Hapësinore "Kennedy" të NASA-s në Florida përpara nisjes së saj inauguruese në ISS.

"Përfundimi me sukses i një fushate tepër rigoroze testimi mjedisor në partneritet të ngushtë me NASA-n është një moment historik i rëndësishëm dhe e vendos 'Dream Chaser' në rrugën e duhur për operacionet më vonë këtë vit", - tha CEO i "Sierra Space", Tom Vice.

"Ky është viti që ne kalojmë nga kërkimi dhe zhvillimi rigoroz në operacionet e rregullta orbitale dhe duke e bërë këtë transformojmë mënyrën se si lidhim hapësirën dhe Tokën".

Nuk është zbuluar një datë specifike për misionin, megjithëse disa burime thonë se mund të jetë muajin e ardhshëm. Në vitin 2021, kompanisë iu siguruan 1.4 miliardë dollarë për projektin "Dream Chaser", pas financimit fillestar nga NASA prej 80 milionë.

Megjithëse projekti është i orientuar drejt dërgimit të astronautëve profesionistë në hapësirë, kompania nuk e ka përjashtuar mundësinë e përdorimit të "Dream Chaser" për



Aeroplani hapësinor "Dream Chaser" do të çojë njerëzit dhe ngarkesat në orbitën e ulët të Tokës. Përshkrimi i artistit tregon se si do të duket "Dream Chaser" ndërsa është ankoruar në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës (ISS).

udhëtime turistike më vonë në të ardhmen.

Nisjet e "Starliner" të "Boeing"

Dhjetor 2019: Fluturimi i parë pa ekuipazh. Arriti në orbitë, por nuk arriti të lidhej me ISS;

Maj 2022: Fluturimi i dytë pa ekuipazh. U lidh me sukses me ISS;

Maj 2024? Data paraprake për fluturimin e parë me ekuipazh në ISS.

"Dream Chaser" duhet të bëjë udhëtimin e tij drejt hapësirës ngjitur në majën e një rakete, kryesisht sepse nuk mund të gjenerojë shtytjen e nevojshme për të arritur vetëm në hapësirë.

Por pas udhëtimit të tij në hapësirë, "Dream Chaser" do të ndahet nga raketa dhe do të vendosë krahët e saj nga një pozicion i palosur përpara se të fluturojë në ISS dhe të ulet për të lëshuar ngarkesën. "Dream Chaser" do të qëndrojë në stacionin hapësinor për rreth 45 ditë përpara se të bëjë udhëtimin e kthimit në Tokë.

Anija kozmike mund të ulet sa më shpejt, që 11 deri në 15 orë pas nisjes, megjithëse i duhet një dritare e motit të mirë për të tentuar rihyrjen.

Nëse gjithçka shkon sipas planit, "Dream Chaser" do të rihyjë në atmosferën e Tokës dhe do të rrëshqasë në një pistë që do të ulet në objektin e nisjes dhe zbarkimit të "Kennedy", Florida, në stilin e anijes së pensionuar "Space Shuttle" të NASA-s, nga më shumë se një dekade më parë.

"Sierra Space" është një nga tre kompanitë që marrin pjesë në Programin "Commercial Crew" të NASA-s, një iniciativë për të fluturuar ekupe astronautësh në ISS në emër të agjencisë hapësinore.

I themeluar në vitin 2011, programi kishte për qëllim që NASA të kontraktonte zhvillimin e anijeve që mund të kryejnë udhëtimin, në vend që inxhinierët e NASA-s ta bënin vetë.

NASA dha kontrata me çmim fiks prej 4.2 miliardë dollarë për "Boeing" dhe 2.6 miliardë dollarë për "SpaceX" në 2014, gjatë një periudhe kur SHBA duhej të mbështetej në raketat ruse "Soyuz" për udhëtimet në ISS.

"SpaceX" i Elon Musk, deri tani anëtar i suksesshëm i programit, kreu nisjen e tij të parë me ekuipazh në ISS në maj 2020, duke përdorur anijen e tij kozmike "Crew Dragon".



Nëse gjithçka shkon sipas planit, "Dream Chaser" do të rihyjë në atmosferën e Tokës dhe do të rrëshqasë në një pistë që do të ulet në objektin e nisjes dhe zbarkimit të Qendrës Hapësinore "Kennedy", Florida, në stilin e anijes së pensionuar të anijes hapësinore të NASA-s.

LAJMËRIM

QENDRA E KULTURËS, MEDIAS, BOTIMEVE TË MBROJTJES DHE MUZEUT TË FORCAVE TË ARMATOSURA OFRON AKTIVITETE KULTURORE DHE SPORTIVE FALAS PËR FËMIJËT E USHTARAKËVE

PIKTURË

QENDRA E KULTURËS OFRON KURSE PËR TË GJITHË FËMIJËT E APASIONUAR RRETH PIKTURËS

VOLEJBOLL

QENDRA E KULTURËS KRIJON HAPËSIRA EDHE PËR FËMIJËT E APASIONUAR ME SPORTE SI VOLEJBOLLI

PIANO

QENDRA E KULTURËS OFRON KURSE PIANOJE PËR TË GJITHË FËMIJËT ARTDASHËS

BASKETBOLL

QENDRA E KULTURËS OFRON AKTIVITETE TË NDRYSHME EDHE NË SPORTIN E BASKETBOLLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



TË SHTUNË – TË DIEL
ORARI: 09:00 – 12:00

KONTAKT:
0685255501

ADRESA: Rruga e Dibrës, garnizoni
"Skënderbej"